

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I KATËRT



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

WORKS

IV

Editorial board:

Ali Aliu, editor
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA


VËLLIMI I KATËRT

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013



LUM LUMI

Botim i katërt, i plotësuar,
Rozafa, Prishtinë, 2003

Dhimbës sate, Lumi

Babi

BUZË UJIT TË MADH

A DO TË KETË KOHË

Fati im në duar të mia
Në duar të mia dhe vdekja ime
Qeniesia ime në duar të kujt
Kam shpatën dhe frerët në duar
Përtej sime frymë ati le të më shpjerë
A do të ketë kohë

NOKTURNO

E tash ec vetëm
në hapësirë të vdekur
ngula gurin tim të shqetësuar

Ec
qeni qen
sy i shkyer në frëngji të nxirë

Dredha e pluhurit
na humbi udhën
në shkretëtirë

KËLTHITJE

Edhe pak e Bregu s'do të duket

Krejt njësoj
kohën ta mas apo jo

Edhe pak e Mallkimin e arrin Vala

MYSHKU, EMRI

Në Bregun tim nuk dukesh
as valë e lumit tim
nuk të lagë më

Sorra të dergjura
grimcojnë
ëndrrën

dhe myshku emrin në gurë

UJI I MADH

Rrëshqiti edhe Bregu
Qeni cofi duke lehur
pas Qiellit pas Tokës
Uji i Madh e i zi
rrjeta rrënjë
dhe gjumë

Koha e notuesve a perëndoi

VAPA

U nisa drejt Diellit ora binte dymbëdhjetë
Më parë nisa t'i humb gishtat e këmbëve të duarve

krahët

Pastaj rëra zu të ma mbulojë trupin fjalët ëndrrat

Për pak kohë i humba të gjitha: drejtimet betejat

qytetet

Vetëm ora e thyer mbet dhe syri im çel'

Buzë Ujit të Madh

Dhe Diellit

Në zenit

AI DET

E ai det
ëndrrën ma vjedh

kurse unë e gjuaj me vjet

Në rreth e mbyll në fjalë
mure rrënon hapësi pushton

Nëpër nerva gjësendesh
ngjitet deri te Unë në katin 13

Në majë të klithjes sime kacavaret

Dhe shoh rënien
por fundi askund

Ai det

MBRETI IM I VDEKUR DIOKLECIAN

Kur të zgjoj
thellë në lashtësi nxjerr zë
Guri im peshë fiton hapësirë

mbreti im i *vdekur* diokleciat

Ballkani nuk m'ï ngjan pyllit
ma kthen deti liburnën dashurinë
qytete të humbura m'ï kthen ëndrrat

Nuk na ndan vdekja plaku im
harrimi na ndan koha
gjahu i egër i namur

T'ishe do t'ia qitnim kulmin kullës
nuk do të më zinte terri në gjysmë të rrugës
as kokëçarje të kisha me piratët me romakët

Kur të zgjoj
lulon dhembja
dhe herr barin e keq para derës

mbreti im i *vdekur* diokleciat

Split, 1983

MONSTRUMI

Ishte në degë
kur ia zgjata dorën
të hynim në kopsht

Ia mësova emrin alfabetin
shtëpia si ndërtohet
kur rrënohen muret

Kodrave Fushave Detrave shkelëm

Shi degën furishëm e lëviz kthetrat
Mbi plagë time çel ëndrra edhe 'i stinë
Ma ngrin fjalën majë gjuhe

Syrin ma ther dashurinë mijëvjeçare
Cipërdoncullak ma zdesht shpirtin
Poezinë

Me kokën time
në shtizë
shqirret nga bregu tjetër

E dorën ia zgjata

Ndërmjet Njeriut dhe Bishës
ia shpjegova dallimin
para se të hynim në kopsht

Stamboll, 80 - 1998

DUMVENIO*

Ti i vdekur zatën ishe
Përgjithmonë tash të shoh të vdekur

Betoni i pafund e i ftohtë hataja
makinat e ndryshkëta qentë e cofur

Gjumi i gjithçkafit Eklipsi a thua

S'arrita në derën tënde të trokas
Të më japësh një pikë ujë s'arrite

as dritaren të ma hapësh pakëz

N'ëndërr dikund takohemi pas sa shekujsh
mbi të qenmen ndërrojmë fjalë mbi të bukurën

E betoni e makinat e qentë e cofur
në hapësirën e shthurur lojë dramatike

Ti i vdekur zatën ishe
Të vdekur të shoh tash përgjithmonë

* Lokalitet ilir te Peja

DIKUND ATY THELLË

Hilmi Aganit

Dikund nën këmbët e tua aty thellë prehet antika e fisit
Uji rëra bari e ruajnë më mirë se jeta jote

Për ty qysh se dihet asgjë jotja s'është e trilluar
vetëm një valle vetëm një këngë s'e ka jeta jote

Kopje e Evropës s'është as erë temjani nuk i vjen

Ti imiton jetën tënde të thjeshtë pa kozmetikë pa patetikë
Vetëm pluhuri pas teje dhe ajo që jeton ndër breza

Kur zotrat grinden fyelli yt simbol i artit tënd të lashtë
mbush zbrazësi dhe 'i dritë kuqëlon n'ajër në gur në mur

Lëshoje teposhtë ç'thotë Evropa e kashelasheve
e myshqeve e podrumeve

E sheh heq më rëndë guri yt kur e vë dorën mbi të
Në shtëpinë tonë qeni ynë kurrë nuk leh-shurdhon
as s'është i anëve tona ai që pas shpine kafshon

Ti del nga shtëpia dhe s'di ku të çel drita por
ti ke antikën tënde dhe jeta e fisit s'e ka vetëm
një këngë vetëm një valle

Opati, 1981

UJKANI

Ditën e mërkurë sollën lajmin
Ujkan Ujkani vdiq

Ditën e enjte morën letër nga ai
kurrkujt asgjë për mua mos i besoni

Ditën e premte hyri xhenazja në shtëpi

Pikërisht në orën dymbëdhjetë
Ujkan Ujkanin e varrosën

Atje poshtë
në udhëkryq

KULLË E LARTË

Esad Mekulit

Zbriste nga majët
me kodin e fisit mbi të bukurën mbi guximin
’i copë qiell ’i copë atDhe krijonte

Fjalën *kushtrim* peshonte fjalën *besë*
lak nuk bënte vëlla i vetëtimave
rrugëve të dashurisë të dhembjes

Ç’i fliste zogut në qiell
nën hijen e Bjeshkëve të Namuna
Lumit ç’i pëshpëriste për zotërat

Në livadh të kositur
u shndërrua në gur e pashë
një popull i urtë tevona
nga ai ngriti mur

Kur zotërat grinden
e gjymtyrët nuk i shihen atDheut
shkrep aty në kujtesë

Lumi ai

1962-1993

FATI NA LA?

E paNjohura do ta mbyll Derën më në fund

Pas nesh vrapon Daniel Defo

miku ynë i vjetër

Kërkon Robinson Kruson

atë zbulues të madh të vetmisë njerëzore

(Qysh se ajo Derë u hap sa shekuj kaluan)

Dëgjoj pastaj rrapllimën e rëndë të një valleje

kujisjen e bravës frymëmarrjen e bimës në gur

Na u ndryshk çelësi apo fati na la

ME JETUE

KËNGA E LIRISË

Çdo gjë jotja lindje e parë
Dhe hapi yt Lumi
Siguria ime

Shushurimë e Pyllit edhe nëpër fjalë
Kafshë e tmerrshme ulërin
DheutAtdheutEvropës

Se zgjohet se lëviz
Se vdiset Lumi
E dëgjon buçimën

I përulen edhe perënditë

Ulqianë, 1979-1999

ME JETUE

Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më larg se Unë

Prandaj:
Bukën ta pjekësh dy herë nën saç
Ujin ta ziesh deri në shkallën 99
Derisa të mbetesh ti i vetmi kërthi në ajër në kohë
në kosmos

Ti dhe Uji

Diellin ta shikosh nga hija e plepit
dhe ta masësh
kur hijen tënde nuk mund ta kapërcesh më
Qenit ruaju se të kafshon ajo kafshë shtëpiake
besnik i madh i Njeriut
Nga kafshimi i gjarprit mund të shpëtosh
Macjen nxirre nga fjalori yt gjithsesi
Ajo nuk është simbol i kohës sate as i artit tënd

(Unë gjithmonë ia kam frikën edhe Lules edhe Femrës)

Kur të flasësh fol të dëgjohesh në bjeshkë
të dëgjohesh në shkretëtirë
Për të dytën herë mbetesh pa kokë ose kush nuk të beson:
Sa më pak shikojë veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: I pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam Unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama
për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë të natës
në pikë të vapës
Asgjë mos rrit asgjë mos krijë me dhunë
Rast i humbur nuk je edhe pse pylli dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë e saj e zezë

Bashkudhëtari im

Ta provojmë vetveten derisa kemi frymë

1979

KËRKON ATË QË NUK MUND TA GJEJ

Lumi
Ti kërkon diçka
që kurrë nuk mund ta gjej

Ti kërkon diçka që moti e kam humbur

Pse Lumi
gjithmonë kërkon atë që nuk mund ta gjej
kur e di
jashtë lëkure nuk mund të dal

Mirë e ke Lumi
vetëm vazhdo me tënden ti
unë megjithatë deri në vdekje
do ta kërktoj atë që e humb

TË DUAN LUMI

Të duan Lumi
kur ti hesht
kur ti nuk kërkon asgjë

kënga jote e pakapshme
për veshin e trashë
të tmerrshme shkronjat e tua
dhe poeti yt dhe vrapi yt

sapo harron
dy herë dy
mund të bëjnë edhe katër
ta luajnë gurin në hapësirë

dhe të duartrokasin
kur ti humb
Lumi

DERI NË FUND

Është dita jote e fundit?

T'i biem deri në fund

Në Orën e Familjes sa nuk dha shpirt

Ai atje larg në hapësi jam unë Lumi

Dhe udhëtuam kah ylli ynë që digjej në kep

Në jetë në art vrasësit më të mëdhenj janë frikacakët

Mjeshtëria e tyre: gjuajtja në gabime dhelpëria

Ti mëso të duash vogëlush Ti mëso të ecësh me

këmbët e tua

Mbi të keqen mbi të mirën mendo me kokë tënde

Kurrë mos pështyji në dashuri mallkim i fisit

Shkolla jote antike: të dish të çelësh derën e shtëpisë

në çdo kohë

të dish të thuash fjalën kur duhet thënë

Urrejtja është më e rëndë se vrasja

Me ditë më shikon nga krevati i vjetër: Spitali tepër i vogël

për dhembjet tua

për plagët tua

për ditët për netët tua plot klithje
Spitali tepër i vogël
i vogël tepër
Spitali
Nën të Danubi i thellë e i kaltër
Tërë jetën do të na vijë era jod sëmundje vdekje
gjak vrerë do të pështyjmë
T'i dezinfektojmë tërë jetën plaçkat ëndrrat fjalët?

Edhe këtë ditë ta kalojmë në Spital?

Të shikoj: Në syrin tënd Flaka Etja Qielli
Në syrin tënd asnjë dredhi asnjë mllef

Pastërtia e syrit tënd më kapërdin të tërin

Në fund të tij
hap fatin e kobshëm

Ai nuk jam Unë
Ti nuk je Ai

Kush jam kush është

Syri yt mbyllet
dhe frëngjia në Kullë

(Poezia më e bukur nuk është shkruar ende
as do të shkruhet
përderisa notojnë zhytësit)

Vogëlushi im çdo fund (nuk) është tragjik
Po ç'ka aty poshtë në materie
Miu i Bardhë
Antimateria

Do të më hapësh si një libër të moçëm të harruar skaj udhe
të mësosh të ecësh nëpër pluhurin tim

Por Ora por Ora jonë shtangu në ajër

Fjalët na u harxhuan këngët
na mundi udhë e frikshme
Jashtë vetvetes na nxori marramendthi

Ti je më i madh vogëlush më i fortë se kjo zyrtësi
T'i biem në fund edhe kësaj dite
për inat

Lum Lumi

Beograd, 1979

EKZISTENCA

Peshën kryesore ta ruash Lumi
Të mos rrëshqasë toka nën këmbë të mos humbasë
qielli mbi kokë
E shoh: herë bie në të djathtë herë në të majtë
Unaza e pestë Unaza e gjashtë bëjnë presion
në boshtin kurrizor
Të lëvizësh në vënd do të thotë të vendnumëros
Hapin tënd vendimtar ti ende s'e bërë qysh se re
Boshti i kurrizit keq të tradhtojë
E shoh kur bie te unë kur bie te nëna
dhe kuptoj dritat që ndizen rreth teje zotynë
Për shkak të tekeve kotnasikot humb peshë
Mbyll sytë Lumi / e sytë janë për të parë
Shurdhon veshët / e veshët janë për të dëgjuar
Derdh dhëmbët / e dhëmbët janë për të
ekzistuar
Shpesh na kthen shpinën me inat prish qetësinë
por unë e di: Ti je zorrë qorre kahmoti
Enigmatik rri vazhdimisht
asgjë deri te ti nuk shpie na i fsheh gjurmët
A kupton: Zorrë qorre je (oh të mos ishte e vërtetë kjo)

Vetëm fryma jote vetëm besimi yt mund të të kthejë
në kohën tonë

Qe prapë lëviz syrin hap veshët shtrëngon
dhëmbët: duhet jetuar

Shoh: Unaza e pestë Unaza e gjashtë bëjnë
presion në boshtin kurrizor

Shoh: ke humbur ndjenjën e të prekurit e të
dëgjuarit e të pamit

Shoh: u mësove me të thera me shqerrje me
mure transfuzione

Imun u bëre ndaj çdo gjëje vogëlush

Mos është pika më e lartë e vdekjes kjo apo
dëshira për të jetuar

Arrite megjithatë ta mbash veten

Kryesore ta ruash peshën Lumi

Të mos rrëshqasë toka nën këmbë të mos humbasë
qielli mbi kokë

Beograd, 1981

HOTEL “MOSKA”, DHOMA 512

Në fund të dhomës: telefoni i zi
zëri i gruas i fëmijëve
dimri siberian në xham
pagjumësia realja
gurgullima e mbytur e Erenikut e Drinit
vaji i përmallshëm i fyellit dikund në Kosovë
vendlindja fëmijëria ime
plot dregëza sharje rrahje ndjekje
mbyllje hermetike në qenie
paartikullimi i ankthit i ëndrrës i dhembjes
humbje e gjithmbarshme e fjalëve e poezisë
shndërrimi në përrallë në mit
i një qeniesie të pathënë telefoni i zi
alo alo alooo hotel “Moska” dhoma 512
mbi të papriturën syri im i shkyer
dhe hukama në fytyrën e ngrirë
të dimrit siberian në xham

Janar 1980, Beograd

DHEMBJA IME

Dhembja ime

ka dy sy dy vesh një hundë

kalem tanushe

ka duar këmbë ashtërore

ka një trup të gjatë 130 cm

dhe një peshë

e cila nuk është konstante

Me ëndrra e ushqej

Ajo rri e më shikon çuditshëm

Ajo rri e më shikon llahtarshëm

e mban gjallë

guximi im

NË DHOMËN E VDEKJES

U mbështeta për muri Vetëm motra Mari ndërron shishet
drita e kuqe zbulon gjymtyrët e lodhura
në hapësirën e shturur
hap syrin lëviz dorën e shtanguar në ajër
ngre nga shtrati trupin e Gjergj Elez Alisë
(brenda frymës që përplaset në Dhomën e Vdekjes
Plepi i Shtëpisë dhe Arapi i Zi)
mbi hijen e nderë mbi fjalët e shkapërderdhura
ashensori bart poezinë e tmerrit
citostatikë kobalti betatroni
pasqyra e gjakut: rënia e leukociteve e eritrociteve
hemaglobini katastrofal
motra Mari fshin djersët pëshpërit kushedi për të satën herë
zoti s'është i zi
s'është i zi zoti
nga bardhësia dhoma verbohët në një guaskë
heshtjeje mbyllet
pas murit zhdukem unë
njeri o njeri i mirë nuk mund të të mos them
se nuk ke jetuar
dhe nuk ke qenë trim

1979

NUK TË RRI BUKUR ASGJËSEND

Në krah të majtë të rrezaton kobalti
në krah të djathtë dyshohet
në sëmundjen e vjetër

Qepe gojë
memec nuk je
Trupit tënd gjak tjetër rrjedh a thua

Nuk të rri bukur asgjësend

Ngris dorën
tremb engjëllin e zi
si nuk e humbi udhën
në ndonjë planet

Ulpianë, 1980-1999

JE E NUK JE

je e nuk je

është luhatur
drejtpeshimi yt
të ha tinëzisht gjaku fryma

mes Murit e teje
ëndrrën ta përgjak
engjëlli i zi

dyzohesh me hijen
fitues apo humbës
në Betejën e Albulenës

orë e çast të ndërron
pasqyra e gjakut
brenda teje rrënon
engjëlli

je e nuk je

rreth Flakës sate
sillem
e nuk mund e shpëtoj

e nuk mund e shpëtoj zoti im

1980-1994

BESONI NËSE KENI ZOT

Lumi do të ndryshojë shumë
Keni parë mish të gjallë
Protokoli amerikan Tabela 9:
Adriomicin Liovak

Të gëlqerosura muret
Dhe lulet prej betonit
Hapësira e mbyllur hermetikisht

Dyert orenditë të ngjyrosura
dhe xhamat
Asnjë pasqyrë në dhomë
E tmerrshme ëndrra

Vizitat të martën dhe të premtën
Të ruhet nga infektimet
Ndalohet rreptësisht prishja e rendit

Kohë dhe durim
Fitojnë ata me nerva konop
Do të ndryshojë shumë Lumi

Protokoli amerikan Tabela 9
Adriomicin Liovak
Shpresë e vetme

Besoni nëse keni Zot

1980-1994

SHUSHATJE

Nocioni kohë nuk thoshte gjë në kohën time
por koha ime në kohën tënde Lumi
thoshte ekzistencë

Buzë Danubit fishkëlloja një këngë të moçme
Tërë i shthurur hyja kinemave teatrove kabareve
Në hotel Moska shurdhoja telefonin
Zbrazja shishe të ujit mineral pija çaj
medikamente

Gripoz na ishte ajri hapësira e zyrtë nervoze
Kushedi për të satën herë lexoja Shokun Zylo
Kuti konservash gazeta të verdha të grisura
erëra këpucësh erëra çorapësh djersësh
smogu të dhiera mizash të cofta lëvozhga frutash
lajme taze lajme bajate
mbushej dhoma 512
bagazh i një të qenme

Birucave kafeneve të vetëquajturit shkrimtarë artistë
zinin në thua në vegsh
thyenin dhëmbë zgurdullonin sytë shqirreshin
rreth teoriçkave rreth fustanave *a la perëndim*
a la lindje

Nata mitike dita pa vesh pa sy

Në delirium binin në fjalë inerte humbnin: a ka zot a s'ka

Në strofa çalamane në monokolona monotonia

pagjakësia: pikë vdekjeje

fytyra engjujsh djajsh perëndish leshatukë idhujsh

nëpër mure të rëna

në tym temjani fantazma të gjalla të betejave

të rreme

seksshope seksgrupe ishuj të vetmuar orgji

deri në çmendi

erë sperme vagine penisi menstruacionesh

mujore vjetore stinore

dhe pis pis pis mbyllej nata në dry në rrashtë

Pranë dritareve nën çatitë e lodhura në periferi

në rreth

botën në gjumë vinin pederët:

o more dylberi i bacës

Këngë pederësh e kohë gjumi s'ishte

Të shpëlarët të krekosurit të hekurosurit vinin rend-rend

arti nuk është folklor

logos është timbër

kavallKavalliKavallohejKavallo
Rrahnin ujë në havan prej mëngjesi në mbrëmje
prej mbrëmjeje në mëngjes
Simpoziume kokteje ekstrakokteje pleh deri në gju
Teori të gjora mbi vargje mbi romane të gjorë
psikanalizë e rëndë

Duke qëndisur duke bërë ojna duke bërë sehire
mplakeshin gjenitë
në bisht të Evropës

Fjalë ëndrra kopnin thonjtë qyrrat thikat myshku harresa
vjellje abortime drogime helmime

Mjete më të reja kontraceptive reklamoni shtypi TV-ja
Mjerë ne
Evropa do ta vrasë vetveten
do të ngulitet majë Ajfelit nga dendësia jonë
Zonja nuk do të na këqyrë as me bythë
Ruajeni shëndetin prej shterpësisë prej pastërtisë
Jeta tepër e ëmbël
por koha e shushatur
Vrapoja pa frymë kah ti Lumi

(Dhjetë herë në ditë i bleja të njëjtit stripa
Emra as data nuk mbaja mend
Dhjetë herë me një biletë hipja në autobusin urban nr.16)
Ti qeshje: Babi është bërë harraq
Ku i mbet koka babit
Babi sa shumë ka ndërruar
Dikund në rrugën Rifat Burgjeviqi
Dikund në Bulevardin Mbretëria e Humbur
Kacafytesha deri vonë me Koshavën
Kush ka dhëmbë më të forte
Në Tashmajdan në Kalemegdan
Pagjumësinë e fisit bartja prushin e dherave të mia

Kaltrinë e ujërave të Drinit të Bardhë
Në Adë shtrija lëkurën time ilire lodhjen
vrapin shekullor
Por ka fund Vaterloja jote
Nocioni kohë nuk thoshte gjë në kohën time
Por koha ime në kohën tënde Lumi
thoshte ekzistencë

Beograd, 10.IV.1980

DO TË KTHEJ NË TASHMEJDAN

Do të kthej aty
të kujtoj ditën
kur harrove të ecësh
Të loz me hijen tënde
të fshehur pas drunjve e
të nxë fluturën që të zgjonte
në shishe pavdekësie ta mbyll

Do të kthej aty
edhe njëherë fëmijë
në ringishpil e kohën tjetër
ta lidh për këmbë lejleku
Diellin e jugut të sjellë
shushurimën e ujërave
kaltërinë e qiejve

Dhe do të ik pastaj Lumi
në mbretërinë e gurëve
të më mbështjellë
vel i akullt i hënës

1981-1992

JETË KREJTËSISHT ARTISTIKE

Dr. D.Vulloviq, i cili mjekoi Lumin

Ha ushqim të lirë
ajër të karbonizuar thith
vesh tesha të arnuara

Për trupin tim
prerë asgjë tamam
E kaloj kohën në vrap
me i'sy gjumë metrove

Vuaj nga sëmundja e dheut
përplasjeve lashë dhëmbë
ilaç kërkoh për sy

Me and'rrue nuk and'rroj
dashuri çoj në mënyrën time
shtëpinë plot fëmijë

Nuk më shkon zëri të këndoj
thonë vesh kam
të dëgjoj vetëm
murmurimën mbi kokë

Paris, 1981-2002

PARISI, VENDLINDJA

Do të hyjmë në paris
gurin tonë aty do ta ngulim
nuk do të na presë teuta genti
nuk do të na presë hordhi e egër romake
nuk do të na presë njeri i gjallë
në paris do të hyjmë
ëndrrat do t'i varim në krahë të lejlekëve
te një krua do t'i lajmë sytë duart lythore
do t'i lëmë netët ballkanike pas shpine
 vallet këngët baladat përrallat
vetëm fyellin do ta marrim
t'i biem kur të na rrokë malli
 kur humbim në grumbullin e klosharëve
 të hijeve
 të minjve
deri vonë rrugëve të parisit në metro marramenthi
do t'i marrim erë ftoit të vendlindjes
për kohët pis do të flasim me gishta
nuk do të shkelim asnjë mizë
nuk do të trembim asnjë zog
nuk do të derdhim zjarr vrer
 mbi kokë të njeriut

Evropës së përgjumur s'do t'i përulemi
as perëndive të krisura
besën ma jep Lumi
se nuk do ta harrojmë vendlindjen

Paris, maj 1981

NËN DRITARE DIGJEJ PARISI

Net të tëra nuk flija
nën dritare digjej parisi
shanselize sheshi konkord opera
kulla e Eifelit harku triumfal orli notër dam
shpërnguleshin në nëntokë mjerë romantika
iknin me trenin e parë me trenin e mbramë
të verbër topallë gërrbana qyrrana tullacë
mullacakë
të rralluar të krisur idiotë gjeni gjysmëgjëni
shkrimtarë
muzikanë piktorë varrtarë disidentë pederë
fauna flora e paparë në asnjë kopsht
zoo-botanikë
nga degët saltomortalet më të çuditshme të majmunëve
binin pa krye
dikund

art i madh francez evropian panair ndërkombëtar

mbyllja sytë hundët veshët shtrëngoja dhëmbët
bërtisja në ankth
por gjithçka ishte e shurdhët memece

megjithëse parisi varrosej përsëgjalli
me tërë bërlllogun parfumerinë neverinë
grua e lëshuar

ti flije thellë në gjumin ballkanik këmbekrye bashkë
asgjë s'të pengonte as zëri tmerrues i nëntokës
as mjeshtria e çollakëve në zë
ç'ëndërroje vallë
ëndrra jote athua i ngjante ëndrrës sime
a ishte e bardhë o zot a kishte diçka të Kosovës

vështroja qiellin e rëndë të ftohtë: asnjë zog
qielli thua për inat më shtypte palmuç më bënte
frymën ma prente
më përplaste për mure derisa llastik bëhesha
mos isha send i harruar në udhë

e nën dritare digjej parisi
thellë në natë në qenie trenat rrapëllonin
bartnin ëndrra gjithfarë ngjyrash këmbë të djegura
të përgjakura duar të sakatosura koka të çara
sy të zgurdulluar
sy pa bebëza të errët dhëmbë të grirë në havan
mijëvjeçarë

zorrë të copëtuara për qejf bodrumeve
kasaphaneve mesjetare
zemra të kafshuara-helmuara brinjëmushkëri
mëlçi kanceroze
dhe
nuk mbaj mend një kohë të ketë pasur
aq shumë xhenaze
mbi dhé të pavarrosura

ti ngriheshe mbi re e unë thosha: Lumi është
i thellë
i pashtershëm
i pakapërcyeshëm
dhe përplasesha për mure korridoreve të
ftohta të errta të pafundta
ikja prej vërshimave ëndrrave zjarrit
kohë e gjimnastikës antike na ish
në fytyrën time të verdhë të përgjumur pështyja
vizatoja fytyrën e vendlindjes
shkelja hijen time të shalakatur
shaja në zot shaja në nënë

hapësira e kuqe vetëm vilzhyifi

e ti Lum Lumi s'u përngjaje aspak lumenjve
të maleve tona
më tepër një krijese fantastike
dali shagali ç'do të kërkonin më shumë nga një
lëvizje jote mahnitëse
në qiellin e lodhur të parisit
në ashtin tënd më e thellë ishte dhembja jote shëtitëse
se çdo gjë misterioze e senës
më e rëndë se ngjyra e zezë e trenave që bartnin
parisin e metastazuar shtatzaninë e shekullit
dhe besoja në bukurinë tënde se do të mundë çdo gjë
por ç'bukuri është ajo lum vogëlushi
kur edhe nuk vyshket

ti ishe njeri i gjallë prej gjaku prej mishi
net të tëra nuk flija
zhantiji i humbur në hapësirën gëlltitëse
të tmerrshme të vdekur

e nën dritare digjej parisi

Paris, 5.XI.1981

RRENË KLLUQE

Qeshu njëherë Lumi
Mure të forta kemi të larta
As vdekja të përbirohet
Kullë prej guri më
Oso Kukë Shkodrani s'e pat
S'u marrim dorë Zjarrit as Ujit të Madh
Vezën e fatit majë oxhaku
Lejlek i bardhë e çokat
do çelë njëherë
Do e ruajnë qen Sharri
Sorra gjarpërinj minj
do i qesin fare
Midis kopshtit
do rritet 'i lis thik në qiell
një lumë nuk do shter kurrë Lumi
Nën vetull të Bukurës së Dheut
lulegjakun do e vadis
Do i biesh fyellit ti
Nuk do hamë bukë thatë
Nuk do na përgjaken këmbët Majës
As e ngulim kot gozhdën
Qumësht shpenish do pijmë
Do hamë mish kaprojsh

Më shumë se bukë më shumë se krip do ketë
Nga qoftëlargu ruana Zot
Sarcoma leukemia ç'janë
Zorra qorre testimi nervor
 ndërrim kohe një teshme gaz
Do mbretërojë qetësi varri
Mjekë më shumë ka se njerëz
Njëmijë vjet qe besa do jetosh Lumi
Do shkoj verës në Ulqin
 do e mbys peshkaqenin
Në stepe do të dal
 do e gjuaj ariun polar
Damask Halep do i pushtoj prapë
Te ndonjë arnaut te ndonjë arab
do e kërkoj Llampën e Alajdinit
E lirojmë katallanin në dhomën tënde
Do jetë i urtë si çdo vdektar
Të mbron nga syri i keq
derisa unë çel pyllin rreth shtëpisë
arinj peshkaqen derisa gjuaj
Në Horën Arbëreshe shkel pastaj
Me Don Vito Korleonen
do zbresim në fund të deteve

Arin e mbretërive ta nxjerrim
Të mos ketë të varfër në botë
urie-padrejtësie kush të mos vdesë
Në Palermo do i mbyllim
 Katakombet e Kampuçit
Nuk mund e shoh një fëmijë si rri aq qetë
 mes gjithë atyre kufomave
 As në ëndërr nuk mund e shoh
Do t'u vemë dryrin e harresës
Lumi të gjitha do t'i kemi
 Të gjitha
Ha ha ha
Ende më beson a
 marroçi im i vogël

Unë rrej bre më shumë se Dreni se Iliri
 Rrej më shumë se krejt Ulpiana Dardania
Vetëm ti do jetosh njëmijë vjet
 Zotynë
Ha ha ha
Ha ha
Ha
Malum o Lumi

Paris, 1981, Ulpianë, 2001

PRAPË TË LINDËSH

Nuk mund të na ndjekësh as në këngë

Mbi botën e zgjuar mbyll syrin

E ti ishe

Ai që ia vodhe zjarrin Zeusit

Ai që ia there syrin Polifemit

Ai që ia tregove udhën Ulksit Skënderbeut

Për në Itakë

Për në Krujë

Na ishte i llahtarshëm vrapi yt e

Asnjë dekoratë për trimëri

Mbete ai i vjetri vogëlushi im por

Guxo e mos prano se nuk çoje dashuri tinëz

Të kanë parë mëhalla Gërmisë Çabratit

Te Kroni i Panxhallës të kanë parë

Natës fytyrën duke ia larë

Duke zgjuar mëngjesin para gjelave

Deri te Opera të barta

Autove të vdekjes u ika

Te Uolt Dizni të shpie Daut Berisha

Ndodh e zogu përrallor bie në shuplakë
Ndodh por
Poezi tmerri shkruhet vogëlush
kur shpirti bën zap

Në katin e nëntë atje në metro
Vilzhyif - Paris
Kërkon shkrepën xhaxhi Sabri sapo fiket
llëmba
Nata e pabesë
E nuk këndohet në terr për iLirinë

Diçka të vendlindjes pëshpërit ti diçka tënden
Midis Sheshit Konkord ia nis një kënge të moçme
E di ti vogëlush
Ia them asaj kur e çfarë dua unë
E çfarë e kur e do pazari
Këngë nuk është ajo

I mbyll sytë: Nënë
Unë i nis letër: Fitore Podrimjes
Edhe në Paris 'i copë shkëmb

Evropa rrëshqet nën këmbë
Ka temperaturë ka peshë
Shkaktar thonë është kapitali
Mjaft gjakun na piu
Te Bastia: dritare të thyera komunarë të gozhduar
Sena shëtit rrugëve parqeve bulevardëve të zbrazta
Hip mbi Urën Mirabo kalon nëpër Portën Triumfale
Sena bart fëlliçti bart gjak çka nuk bart Sena e dal menç

Nën dritë të shkrepës
kacavaren ëndrrat si në akrepa ore
Mbi të paPriturën syhapur unë

Fluturon ?i korb e fluturon
krahët i thyen
për murin e padukshëm të dritës

Sokaqeve të vetmisë rrokulliset ?i diell
dhe mbyllet në ëndrrën e Lumit
Dikund në Kosovë pikëlon një çati

Nuk ishte e lehtë asgjë zoti im
I dëgjon Artën Rozafën Doruntinën

Hiq dorë nga maratoni rreth planetit

As në këngë nuk mund të na ndjekësh më
pushtues i madh i majave i pikës së lotit

Prap të lindësh vogëlush

1981-2002

NUK KAM BËRË KURRGJË PËR LUMIN

E pranoj nuk kam qenë i qetë asnjëherë
kam bërë njëmijenjë të zeza për të jetuar
e di Lagjja e Bajram Currit e di Lagjja e Cullakëve
e kam prishur qetësinë kur nuk është pritur
kam thyer dritare kam tharë drunj kam shterur kroje
në Pusa të Drinit kam kërcyer nga Urë e Shenjtë
(Mjerë ai që s'ka pasur kurrë në jetë ndonjë
Urë të Shenjtë)

Në fyt kohës i kam mbetur shikoni si shkumon
dëgjoni si turfullon
për shkak të mirësjelljes plehin asnjëherë nuk
e kam nxjerrë jashtë
Lumin kurrë nuk e kam dëgjuar deri në fund
Fjalën këngën vajin s'e kam lënë ta kryejë
shpirtin ia kam prurë në majë të hundës
me shantazhe me kërcënime ia kam helmuar
fëmijërinë
nënë ia kam sharë ia kam sharë fisin zotin
për veshi e kam nxjerr nga shkolla nga loja
nëpër shtëpi e kam ndjekur si i çmendur
E pranoj Lumi ka shkuar më larg: nuk ka pasur
komplekse fare
askujt nuk i është përrulur vetë zotynë ka qenë

ka thyer dritare më shumë se unë lule e ka
bërë lagjen Ulpianën
më mirë e njeh asfalti i nxehtë

Kurrë një rrugë nuk është kthyer shtegut të ri
për të bota nuk ka filluar as nuk ka mbaruar
në Gjakovë
ka qenë më kokëfortë se unë disa herë është përgjakur
(Për të vërtetën u zura or baba më thoshte
dhe nuk e shihja sa kohë)
nuk ka qenë i kënaqur me qetësi në shtëpi
të rrijë një dritare çel vazhdimisht ka kërkuar
pa i rënë në fund kurrë nuk ka pasur për zakon
ta mbyllë përrallën
as ç'sheh n'ëndërr të shkruajë të vizatojë
aq shumë e ka ëndërruar bukëndoren sa
dhëmbët i ka thyer nëpër vjershat kosovarçe
më ka dashur më shumë se unë atë
nuk më ka denoncuar për mall të botës
ajo që flitet për të nuk është e vërtetë
në bixhoz asgjë nuk ka lënë
ndryshe nga Evropa kohën-hapësirën ai e ka kuptuar

nuk e ka kaluar si xhaxhi Ramiz duke parë
filma porno
apo në gjueti zhure orgji si ai fqiu ynë tralala
jeta nuk është vetëm lakuriqhane sekshane leshhane
Nuk është e vërtetë se ai nuk do të kthejë më
do ta shihni një mëngjes
prej zërit prej hijes një mbrëmje do ta njihni
më kanë thënë ende kokën e bart në shpinë
në Hadë e kanë parë e kanë parë në Albulenë
E pranoj nuk kam bërë mirë që kam folur haptas
për sëmundjen e Lumit

që jam marrë aq shumë me të duke i rënë në qafë
Evropës Stepës së gjorë
diagnoza ka qenë e rëndë: Sarcoma dr.Ervin
Ginsberg d.v.
Nga një dritare në një qytet të tmerrshëm një vashëz
Ujanën tërë kohën e ka mbushur me LuleLumi
prej askujt nuk kam mundur ta fsheh
sëmundja e Lumit nuk është vetëm sëmundje
e Lumit

Djali im i madh Dreni tash ma përplas derën
vajza ime Donika ma kthen shpinën
gruaja më thotë: a do të bësh diç për Lumin burro
veç shpirti i ka mbetur
Lumi ngre vetëm dorën e zhveshur të tharë
unë vazhdoj të prish qetësinë në shtëpi duke
ndjekur engjëllin e zi
të gjallëve të vdekurve u telefonoj
thyej dritare kërkoj hapësi më të madhe
për shpirtin tim
kaloj natën me mullacakë me monstrumë
me mure të vdekura
ende po u shkruaka poezia
ende po u fshehkan sendet nga vetvetja
ende Evropa po jetuaka nga instinkti
ndiej si dridhet shtëpia nga shurdhimi i qetësisë
shoh: kati im i katërt herë kat i parë herë kat i trembëdhjetë
hyj në shtëpi të huaj
Një karrige luhatet para dritares së gozhduar
gruaja e paNjohur
tri net pa i kaluar me mua
aborton

në ajër vizatohet koka
koka e Lumit tim
në ajër në hobe
Atje poshtë Evropa shikohet në pasqyrë dhëmbët pastron
ha me qen fle me qen dëbohet me qen vdes për qen
flet për humanitet arte defilozofim
te një krua gjak i pikojnë duart
dhëmbët prapë i shkëlqejnë e një vazhëz mbyll dritaren
Ujana nuk shikohej prej LuleLumit
Evropa lakuriqohet
nëpër syze rafteve gozhdave ndryshket logjika
nga trupi i tij i Gjergjelezalisë
shkëputet hija ime
varr i gjallë
një grusht dhë një grusht dhë ju lutem amin amin
Dikush ndez llambën dhe shoh pastruesen si e lan
edhe shkallën e fundit
më në fund Dreni e paska qëlluar miun e kuzhinës
E pranoj nuk kam bërë kurrjë për Lumin
bile as sa të zitë e thonit
vazhdimisht e kam ngacmuar:

Lumi a ta bëjmë këtë Lumi a ta bëjmë atë
a t'i
por Lumi Lumiiii
Pse moj grua e vë atë shami të zezë
kur i kemi fëmijët e tjerë Pse

Lexoj në shtyp: një vashëz u mbyt në Ujanë
nga pikëllimi i madh i brigjeve
Për besë nuk është e vërtetë se nuk e kam dashur Njerinë
vetëm kam dëshiruar të ndryshoj
mënyrën e jetesës sime e asgjë tjetër
më mirë le ta thotë këtë vetë Lumi
kur të kthejë një mëngjes
kur të duket një mbrëmje
me sy plot QiellTokëBleruarKaltruar
më kanë thënë prapë e bart kokën në shpinë
në Had e kanë parë E kanë parë në Albulenë
Vetëm njëri sy të më mbet çel'
nuk mund të besoj Lumi
se ti se ti...

HISTORIA E NJË NËNE

Fitores, sime shoqe

Ajo mban mend të gjitha datat stinët kohët
Kur e si filloi
Krizat Lëvizjet Frymëmarrjet
Rëniet Ngritjet
Përhëndetjet e Lumit

Është nënë

Ju lutem mësoni ta përfundojë udhëtimin
rreth atij dielli që fiket
I ka të gjalla kujtimet
Një det pika e lotit

I duhet kohë të harrojë
ç'pa e përjetoi
derisa Lumi bënte luftën e fundit
me engjëllin e zi

E vëreni hijen e saj si shtang
para çdo thyerje?

Ajo kthen dhe di ç'do të thotë
të humbësh betejën

Nënë është

Ulpianë, 1981-1997

VDEKJA DHE LUMI

GABOVE KUR THE

Unë jam Zoti yt Lumi

Amin

Gabove kur the

Lumi unë lumi

DORA IME GJITHÇKA ARRIN

Në vetminë time të ujkut
ditët numëroj netët orët

Në frëngji sapo qet kokën
qiellin ta fsheh zogu im

Se dora ime gjithçka arrin

MBJELL QETËSI

Qytete të përhirta kur ndërtoj
bëj pastrimin e trupit e trurit
e shpirtit e ëndrrave
Qetësi mbjell për rrjetim të ri

VDEKTARËT

Lulja ime luletherra
Te Dera e Vajit

Lulekuqja lulja jote
Te Guri i Varrit

Medet

KUR KAPËRCEN FLAKËN

Kur kapërcen flakën
Guximi yt më zgjon

Nuk mund të ekzistoj
pa ty

As dita ime nuk vjen
Pa natën tënde të gjatë

DROJ NGA SENDET

Kur nuk kam ç'të bëj
trazoj mbretërinë time të vdekshme
Se droj nga sendet
që nuk ndërrojnë vend
njëherë në njëqind vjet

NË SKAJ NATE NË SKAJ DITE

Nuk ka fshehtësi për mua

Të arrij në skaj nate
në skaj dite

Shikoje gurin: kur ngre dorë
humb peshë durim trajtë
tokë humb qiell

Shikoje zogun: harron të këndojë
kur matet hapësirën time
ta kalojë

Ti nuk heq më rëndë
se hiri i këngës

GJYSMË NË ËNDËRR

Merimangën e padukshme
kalorësi e zezë e end
gjysmë n'ëndërr gjysmë në zhgëndërr
prek fundin
por magjia ime nuk përfundon

NUK MË MASHTRON BUKURIA JOTE

Vishkull në titërr të lëndinës
Me Lulëkuqen në dorë ngarend

Nuk më mashtron bukuria jote
Vetëm loja ime nuk është abstrakte

MALUM O LUMI

Unë jam Zoti yt:
Amin

Trillova kohën e tretë
të të mos zgjojë asgjë

Udhëtimi yt mbyllet me klithma
me ardhjevajtje marramendëse
me humbjet

malum o Lumi

1981-2000

NË MBRETËRINË E HUMBUR

KUJTIMI PËR GJAHTARIN E VJETËR

Dy qen të bardhë na pritnin te hotel Mështekna
dy qen të bardhë
dhe gjahtari i vjetër

Ta shprishnin fytyrës hijen e zezë
Gishtave gjunjve lëpinin sëmundjen vdekjen
Shtrojerave livadheve gurrave pyllnajeve
dy qen të bardhë humbnin me ty Lumi

Te hotel Mështekna prapë
heshtje e Sharrit shembi qiej në sy tanë
për dy qentë e bardhë
dhe gjahtarin e ujqve

Në pyll thellë atje diçka ndodhi
diçka e trishtë vogëlushi im
me qetësinë tonë të gastartë

Po munde gjeje Majën e Lybetenit

Sharr, 1981

TE SHKOSH NË BEJRUT

Në vitin njëmijëntëqindekatërdhjetenjë
Dikund në fusha të djegura të Sremit
Dikund në pyje të errta të Sharrit
Ra luftëtari ynë i lirisë

Ti heq shpirt me kokë në jastëk
turp vogëlushi
Im

Ke mundur tekefundit të ngjeshësh armët e Asimit
E të shkosh në Bejrut
Të vdesësh për Palestinën

Korrik, 1982

UNË NUK JAM AI

Ai pranë dritares
nuk jam unë
është jot ëmë
që të kërkon në turmë

ai në fund të dhomës së errët
nuk jam unë
është yt vëlla
që përmallshëm fyellit i bie

ai para pasqyrës
nuk jam unë
është jot motër
që flokët shkurton

Lum Lumi
unë jam ai që derën hap

PIKËLLIMË

Unë nuk qaj
shi bie vogëlushi im
shkundet plepi i shtëpisë

Unë nuk këlthas
nën dritare vogëlushi im
coft ra korbi i Edgar Allan Posë

Unë nuk luaj vendit
muret lëvizin sendet vogëlushi im
vjeshtë e keqe mori

Re e zezë shtëpinë tonë mbështoll

Sharr, 1981

E KLITH NË ËNDËRR

I bukur vetë Zoti
Ku tërë kjo hijeshi
Nga qiejt paska rënë
a dalë fundit të dheut
Në sytë e tu
Copa nate Lumi
Shpërthime gejzeresh
Bie pranë meje e s'di
Zgjohet kush E fryma jote
Thyen e rrapëllon mureve
Ia shkove edhe Zotit
Të paNjohurës i afrohesh
Unë mbyllem në dhimbje
E klith në ëndërr
Dëgjon vogëlush?

29 shtator 1982

FILLIKAT VETËM

Shkove një bregu që ndante
jetë dhe vdekje

ishe i vetëm dhe i qetë
kur të afrohej zjarri

në mbarim të verës mbylla derën
mos ta vrasë kush ëndrrën

fillikat vetëm
tmerri i Zotit

VDEKJA MË E SHPEJTË SE UNË

Larg shumë larg Lumi
këmbët më ranë bërrylat m'u përgjakën
duke të ndjekur

Tash je larg tepër larg
vdekja më e shpejtë se unë

Ulpianë, tetor 1982

E TI I VDEKUR

Ishte verë
Mbi kokë dielli
Hije ti rreth Evrope

Nga udhëtimi i tmerrshëm
Ktheve 'i ditë syzgurdulluar
Në poezinë e babit hyre pa trokitur

Je më i sigurt aty Lumi
Për besë nuk të gjen
Një e zezë

Verë ishte
Në perëndim dielli
E ti i vdekur dhé

NË MBRETËRINË E HUMBUR

Ike
nga dëshira
me jetue

Por
të gjallët
s'i lë ende të qetë

Trimat nuk vajtohen
Dritë paç në mbretërinë tënde
të humbur

Ulpianë, 1982

FLETË E BARDHË

Mbi tavolinë

fletë e bardhë Aty do shkruar:

Lum Podrimja vdiq më 29 shtator 1982

Por unë nuk mund ta nënshkruaj vdekjen tënde

të ndjej në qenie si lëviz si merr frymë

të shoh në jetë gjithkund të prek

Vdekjen tënde nuk mund ta nënshkruaj vogëlush

varrmihësit le ta qesin emrin

ose bardhësia të më mbulojë

edhe mua të tërin

Ulpianë, tetor, 1982

KËNGA E REXHËS

I përvjel pantallonat
Në brez fyellin
Teshekotesh në strajcë

Kaloj Ujin e Madh
Isba apo jam
Zot i dheut i qiejve

Në Korin e Shurdhët
Një zë tjerr holl
Nuk është Ai

Shpinën ia kthej Murit
Vetmia ther vetveten
Në karrigë të një perëndie

Në horizont thellë në terr
Shtëpinë e merr uji
Dhe ulërimë dhe tmerr

Në Breg dal 'i mot

Ia them Këngës së Rexhës
Bjeshkë lëvizin e
lëvizin fusha Po nuk zgjohet

Po nuk zgjohet Lumi

1983-1999

VISHKULL

Kam vetëm
vetëm kam
dhe kam vetëm
vishkull jam
Zot nëse je

KUJTESA

Të gjitha më kujtohen të gjitha

Lumi kishte qarë
Vetëm njëherë

Kishte ndodhur kjo
 më bëhet
tek e pa veten
në sytë e mi të zmadhuar
 nga tmerri

Ishte kohë e akullt e llahtarshme
fundi i një zjarmie
njerëzore

1981

DITA QË MA KUJTON VDEKJEN

Është një ditë
Nuk ka asgjë nga ditët
Ngulitet si gozhdë
Dëgjon dëneset

Je një Gjergj Elez Ali
Kërkon të humburën
E plagë merr nga zotërat

Është një ditë
Vjen me fërflazë me ikje shtërgu
Me shpërthime të mëdha në kujtesë
E drithmë

Në sy ia pi lotin një nëne

Nuk e përthekon me jetë
As i bie te gjuri kush
Kohë shkohon e flitet
Si për Atlantidë e Krujë

Është një ditë
I pavdekshëm ta kujton
As guri nuk është

Falemnderës Lumi
Desh më turpëroi
Hija e vdekjes

Ulqianë, 29 shtator 2000

NJË JETË

padiktueshëm hiri
pushton edhe fijën e barit
mes dhëmbëve

zog i madh i dritës
do fluturojë pastaj

nuk shihet se
na merr në gji
qielli

2002

HYRJE NË TEMPULL

PËRBINDËSHI

Na ngujoi 'i përbindësh
Zana e shitoftë

Para Portës së Gurit qëndron
qysh kur foli gjaku

Bëni vend
në zjarrishte

Le t'i bien
edhe thonjtë

Tek na kërkon rrënjën

1978-1998

GJARPRI, BUKURIA

Mbyta gjarprin të hyj në kohën tënde

Ç'po më dendëson zbrazësia jote nëpër huqet e mia

BESA

Terr i vdekjes të më mbulojë
të ma vëjnë kokën në hu
po nuk dola në Breg
 gjallë ose i vdekur
Më afër tokës se qiellit
 trupi im

DASHURIA, FJALËT

Trimëria ime më e madhe:
Dashurinë ta shpëtoj nga Fjalët
Dhembët duhet t'ia ndërroj
Dhe t'i krijoj kohë tjetër

IK NGA HIJA JOTE

Ngre dorë nga gjithçka jotja

buzë ujërave pranë vullkaneve
të kam zdashur nga misteret

as për pesë para ani yt

Ik nga hija jote nga syri yt
nga të prekurit tënd nga fati i verbër

s'e pe 'i të bardhë
e gjatë u more me mua

Dua t'ua prish qetësinë drunjve
barit tokës saloneve

Në këmbë ta pres vdekjen
se humba veten pas teje

1988-1997

DASHURIA

Koha është të duhemi
Të kesh besim në mua kur të them: trime
Të kem besim në ty kur më thua: trim
Për kokën time kryeneçe shumë kurtha ngrite
Babai yt e fisi shumë pushkë zbraz
Njëmijënjë të zezë kurdise të ma nxije pritën
 e nën një kulm banonim
Me ditë më peshove nga frëngjia
Në hijen e Kullës lexoja Shekspirin me vite
U fishkëlloja deleve buzë Drinit telartë Sharrit
Ma ruaj syrin dashuria ime
 komitët na bezdisin vrastarë
Dorën ma zgjat Uji i Madh gërryen Bregun
I huaj nuk jam as vij nga Tokë e Vdekshme
Në fund të livadhit të kositur e sheh
 yni është kali i bardhë
Shikomë në sy lëri sharjet fjalët gjaqet
 do e sjell lulen nga palcë e gurit
 në Kullë llambën do e ndez
 do e hedh farën në tokën e shpërpushur
Kur të deshta çoje dashuri pas shtatë katundeve
 e të rënat të forta i kishe

kur më deshte bëja dashuri me një grua të marrë
e mëhalla jetonte nga shpifjet
Na iku jeta trime e nuk menduam pakëz edhe për vete
Koha është të duhemi

HYRJE NË TEMPULL

U takuam papandehur
në kohë të gurit ndoshta
ose kur Cezari kapërcente
Ujin e Madh

Dhe kishim harruar
se vjen
edhe vdekja

Jemi apo ishim
’i shpirt
’i trup

Për dy ujë
nuk ka vend
në tempull

1994

FRIKA

Të doli kënga
Ruaje se e vret
Nën çati fluturon qyqja

HARRIMI

Dele dele dele

e

Bariu

Tufën kërkon

PASTËRTI NJERËZORE

POPULLI

Në hije të plepave të kasollave të rrokaqiejve
kthen Populli
nga arat fabrikat universitetet

Libra të vjetër shfleton libra të rinj
me zë bisedon pa zë
nëpër labirinte të shekullit

Gruaja e paNjohur luan çuçek
nxjerr gjirin e madh
në tryezë derdh tëmbilin deri në pikë

Populli lëpinë buzët pi birrë për një çast
harron kohën e shkuar
harron lodhjen fëmijët
birrë pi miza gjuan
metafizika e një kënaqësie

Kafshon bukën me dhëmbë të zez
me dhëmbë të artë
sytë xixëllojnë veshët ushtojnë

Gruaja e paNjohur zdesht fustanin të vjetër
kushedi sa shekuj
pastaj kombinezonin
çorapët brekët

Ajo nuk është Eva nëse jemi Adami
ulëron hapësira-koha
fije fije bëhet dita-nata
në theqafje

Populli djersitet lëshon kuranin biblën manifestin
u kthen shpinën engjëjve perëndive
mbështetet për mur kafshon gjuhën

Gruaja e paNjohur shkimb llampën
ngre këmbën e djathtë
ngre të majtën

Populli mbyllet në kasolla në rrokaqiej në simbol
po fëmijët nuk lindin po fëmijët vdesin nga marihuana

Populli bëhet nevrík ka frikë nga papastërtia
ka frikë nga vetvetja

Ai është lodhur tek kërkon poetikën e të *qenmes*
vetëm birrë pi TV shikon ditënatë: reklama seks vrasje
shtypi: asgjë të re
deri kur ky absurd
vapë dimër bën në shpirt në ëndërr

Populli ha bukë Populli trillon shkallët kafazin gurin

Gruaja e paNjohur ul këmbën e djathtë
ul këmbën e majtë
vesh çorapët brekët kombinezonin fustanin
ndez llambën
Filmi këputet diku papritur e kujtuar

Populli thyen dyer dritare shqirret rrihet
pi birrën e vet
dhe mendon: si të mbyllë vrima nevojtoje

Ka frikë nga papastërtia
ka frikë
nga vetvetja

Beograd, 12-22.VII.1980

SHTYPI I VERDHË

Pi kafen e mëngjesit
shtypin shfleton në tabackaffe

Dreqi ta hajë sa lirë shitën
gjuhë e histori e etnos e simbole
tragjedi e çarshisë

Shpik për drekë edhe një skënderbe
përtyp gjatë pështymën e ditës lodhjen
ajrin e ndotë rreth vetes e sendeve të vdekura

Pas ditarit të fundit TV me ag
mbledh fletët e shpërndara në hapësirën e tymosur
i hedh në tualet
higjienë personale apo kolektive

Bën dushimin e shtrihesh në kanape
ndonjë libër urtakësh të moçëm hap
kërkon të vërtetën për vete e fisin

Nga fyerjet mashtrimet gënjeshttrat
nga zgurdullimet ulërimat neuroza
ndien si lirohesh pastaj

dhe kokëdhembjet e përditshmerisë së pistë

Paris, 1981-2002

PASTËRTI NJERËZORE

Daut Berishës

Qen pas qeni mbysim
Zakon i lashtë ky i racës njerëzore
Por kur të marrë fund gjuetia e marrë
E shtohen gjahtarët

Kafshë shtëpiake
Nuk është më
Qeni
As mik i Njeriut

Le të argëtohen fëmijët me minj kërminj
e gjarpërinj

Paris, 1980-2002

A KOLLITET IVANI

Pjerdh Evropën ç' thotë për mua

Dilje nga përrallat e stepës nga kështjellat e carëve
shpaloje krahët trupin fytyrën dhëmbët
dathur dilje tërë e mbytur në temjan

Striptizimi ndodhte

Syve fytyrës trupit t'i shembja djallëzitë mjegullat
Si dua unë dëshiroja të të shoh
Ta zgjatja dorën nga Bregu im

Dorë moti kam çuar nga zotërat
por kur të bekon Ivani
e kuptoj ndëshkim

Vrapoja rrugëve shesheve parqeve
Bërtisja: për pesë para nuk vlen
Ovan Ovani lajmëronte nëntokën për ekceset
e një irredenti

E unë e unë i hiqja dredhë
perandorisë sate të akulltë

Nga përrallat nga kështjellat e carëve ti dilje vazhdimisht

Më bëhej se të njihja se të kisha parë
para njëqind vjetësh
në pellgun e Hidrës dikund apo në ullishtet dalmate

Ti jetoje larg kohës sime plot rreziqe të papritura

Prapë ndjeja si krahu yt i bardhë gishtat e gjatë buzët
shkëputeshin nga qenia ime dhe se si qenia
jote bëhej neurotike

Ikje në stepë mbylleshe në kështjella të carëve
në panotë e Rublovit në manastiret e tymosura të Ivanit

Të frikësonte heshtja ime? E njeriut? Guximi im?
Heshtja ime ç'ishte vallë që të godaste vdekshëm
që përplasej në brendinë tënde rënqethëse
Gangrenë e ariut të droguar? Mos na ishte mortja e bardhë
apo kërthiza e Njeriut të ri që vinte nga larg
me një fyell në buzë

Ç'ishte heshtja ime që trembte kaq shumë ëndrrat tua
nëpër freska të përjargta që zbeheshin
me lavditë nëpër thonj të zezë të përgjakur
të perëndive tua të mbërthyer në Zagorski
në errësirën verbuese të mesjetës
Në orën time zbardhte mëngjesi por
natë bënte ende mbi stepën mejt tek mbyllja
Librin e tmerrshëm për ty

Bënte dhe në shpirtin tënd? Murmuronte?
A kollitej Ivani?

Ngrita dorë mbi zotëra
Pjerdh Evropën ç'thotë për mua

Moskë, nëntor 1981

NË PERIDELLKIN

B. Pasternakut

në Peridellkin do shpalosni
Evroazinë

gjetëm aty një varr të gjallë dhe
tregimin më fantastik
mbi karafilin e freskët

pikonte prej dikah çdo mëngjes
ndonjë i krisur e vënte aty

ishte ky dhe mister i lisave
shushurinin rreth varrit
e shpesh sëpata i arrinte

shkaku i fjalës i madhështisë
vdiste një pyll në Peridellkin

1981

TRËNDAFILI I ZI

E pashë në Zagorski
Zotin e Stepës

Ç'zot na ishte
'i shtegu nuhaste
harrimin

Dhe zgjonte erëra ujëra

Nga plagë e tij
trëndafil i zi
Imazh i vetmisë polare

1981-1998

ZOTI ARMEN

Nuk mund të them se ishte i rralluar
se bënte tregti të palejueshme
për lirinë e Armenisë

Për shpirtin ëndrrat për Araratën armen
lutjet i thoshte në pikë të gjumit
por qielli i zbraztë e tmerronte

As nuk mund e pranoj
se metropoleve kërkonte ndonjë sulltan anadollak
t'ia paguajë edhe ekzilin

Të çonte dot dorë nga lashtësia
Në një sallë aristokrate
dikund në Holivud apo Çikago
zinte vend dhe dëgjonte
Sarojanin si i theksonte
fjalët e moçme armene
nga magjia e të cilave fluturonte
 'i pëllumb i bardhë
që i mungonte qiellit armen

Unë që rastësisht kaloja atypari
dhe kërkoja Librin më të vjetër të uratave
te një mur që kjasonte rashë në gjunjë
për Lumin tim u luta

dhe për Zotin armen që nuk mund e them
se bënte tregti të palejueshme
për lirinë e Armenisë

1981-1994

ARMENIA

Ar(dh)menia

???

!

Erevan, 4 tetor 1981

SHTHURJE

Në hapësirën e shthurur
di ku gjendet shtëpia ime
ku kroi e
ku ara

E Ai hynedel në shtëpinë time
pi ujë në kroit tim e
vringëllon kosë e tij në arën time

Kur nata bie
e del Ujku në gjah
nga larg vjen e më lutet Ai

Ku gjendet shtëpia e tij
ku kroi e
ku ara e Ujkan Ujkanit

Me shtëpinë time orientohem
me kroit e
arën time
në hapësirën e humbur

1976-1993

BOSHËSI DHE HIÇ

Kozmetika ç'duhet

njërën krah e humbe
tjetrën e tërheq zvar

pyet majë globit
Ia qiten pikën Kullës

kokën s'e çan Evropa

tek ndërron maska
vete në haxhillëk

boshësi dhe hiç

PARA TË PANJOHURËS

Do të ngjitem lart
të kyç derë
edhe frëngji

Tepër i hapur

Nuk do të arrij
vështirë të dalloj
mes sendeve të hedhura

Do të ngjitem lart
vetminë do e mund
me fyell

1981

TI ENDE UDHËTON

Pyllit ndodh t'i ikësh
Po Ujkun?
Kësulkuqen ta shpëtosh

Si një perëndi Dodone
udhës së parrahur ngarend

'i bisht ylli
të bën dritë

Skaj nate do e çelësh derën
kushedi se kur
por do më gjesh mua
në mbarim udhe

Duke i zbutur bishtat e Pyllit

Ulqianë, 1978-1998

DREJTPESHIMI

Qerrja kur thyhet thonë gjenden plot rrugë

Do të thotë se i lumi
nuk ka hequr dorë nga drejtpeshimi
as kur humbi në sallën e bardhë

Por
kur Qerrja i mori teposhtëzen
rënia a ishte zgjimi nga ëndrrat nga mbeturinat

Qe prapë nget Qerren e vet të lashtë të rëndë

Një këmbë po qe se thyen
apo humb një krah
nuk do të thotë se ke humbur kokën

Do të thotë se i lumi kërkon vazhdimisht
pikën e vdekur të drejtpeshimit
ndërmjet dy kohëve-lëvizjeve

E atëherë e atëherë Lumi im

ÇËSHTJE

Bën guri të mbetet gur
apo Njeriu duhet të ndërrojë diçka

Të lëshojë pe ta zëmë
në kokëfortësinë e vet

Se është i gjithëpushtetshëm

Ulpianë, 1975

TRAJTAT, ORIGJINA

Ç'u ranë dhëmbët

Botën si e mbani
të rralluarat fjalë
Drejtpehimin e diellit

Në pus ëndrrash
zbret Njeriu
Origjinën gërmon kohët

Në zenit
relievi i fitoreve
dhe mitet moderne

Ç'po na lënë trajtat

KËRKOJ NJERI

MORA UDHË TË TAKOJ NJERI

Mora udhë
të takoj Njeri në grumbull

U bënë vite që e kërkoj
dhe që nuk flas

Paris, maj, 1981

GJUMI I TOKËS

I paloi krahët zog i kaltërt
Te koka vuri gurin e vet
Nuk u zgjua as e pamë më
Gjumë i tokës e kishte zënë
Tek mbyllej në pikë të zezë
universi

Ulpianë, 2002

SHPJEGIMI I DHEMBJES SIME

Libri Lum Lumi ka mbi tri dekada që shkruhet edhe pse ka përjetuar disa botime. Idetë, mesazhet, figuracioni dhe elementet e tjera shprehëse më kanë nxitur t'u rikthehem disa poezive, të cilat kanë pësuar redaktim të thellë, të kenë tjetër sistemim në libër si dhe të nxjerr në pah eliptizmin, veti cilësore në poezinë moderne. Poezia është një udhëtim drejt të panjohurës, ka thënë një i urtë. Shkrimi i saj është punë sizifi. Nuk lind kur ne duam. Latohet derisa ta vjelë maksimumin nga fjala. Për të gjallë të autorit krijimi është qenie e “gjallë”, lëvizëse. Shkaku i një fjale, figure a strofe, autorët shpesh u kthehen teksteve. Edhe në Letrat shqipe ka shembuj. Poezia konsiderohet diçka hyjnore, ngërthen në vete dhe misterin. Vlerën nuk e përcakton sasia. Mbahen mend poetë edhe për një poezi. Ajo që nuk vdes, të vë në veprim vazhdimisht. Lumi nuk simbolizon vetëm fatin e tij tragjik. Aventurën time të bezdisshme në kërkim të sublimes nuk ia kam borxh vetëm kësaj qenieje...

Nuk i kam respektuar disa trajta të gjuhës standarde. Kam dëshiruar të “shpirtëroj” fjalën dhe ta mbaj gjallë kujtimin për Lumin.. .

Ulpianë, 15 janar 2003

Ali Podrimja

FUND I GËZUAR

Botimi i dytë
PEN-i i Kosovës, 2012

FATI

Ai që humb në fushëbetejë
Kur ti luan
me vetveten
është shenjë e mirë

do të thotë ti ekziston

Ai që të ndjek vazhdimisht
të ther e të vret
kur ti udhëton në jetë
është shenjë e mirë

do të thotë ti megjithatë ekziston

Ai që nuk të dëgjon
as nuk të sheh
kur ti kapërcen flakëzezën
është shenjë e keqe

do të thotë ti ke humbur lojën

Ankara, 1980

A JU KUJTOHET

KONSTANTINI

1. Nuk më përzunë
Për të gjallët më mori malli

2. Nën dritën e nurit tim
Parmakë baladash theva

3. Shumë kohë paskam qenë larg shtëpisë
Qenkan rrëzbitur muret gati shterur kroi

Minjtë lëmë e paskan bërë

As në tokë as në qiell oxhaku

4. Nëntë vëllezër ishim
Kopil s'isha oj Nënë

5. Të rruhem e të qethem
Në pasqyrë njerëzore t'i qesh fytyrës sime

Dhëmbët t'i laj sytë
Lëkurën e puçëraftë thonjtë plot dhé

Natën ta hedh nga krahët
Shpirtin ta shkund zërin

6. E pamundur kaq pluhur mbi mua

7. T'i kreh kaçurrelat e verdha
Rrobat e martesës t'i vesh

8. Ka sa vjet që më pret Bubulina

9. Lulen e Nënës ta vë te zemra
Me vete ta marr buzëqeshjen e Doruntinës

Të shkund pemën në kopshtin e shkretë
T'i mbush xhepat plot mollë

Deri te Pragu i Shtëpisë
Të ngrehi këmbën zhag

10. Fyellit t'i bie
E t'i bëj kafshët
Të lozin rreth muranave

11. Atin ta shaloj
Livadhit të Kositur t'i dal në fund

Po të munden
Le të ma shkelin hijen

12. Për të gjallë as për të vdekur
Kush të mos ma qesë këngën

13. Duke u endur baladave
Më ranë këmbët
Më dolën flatrat

14. A do të më njohë
A do ta njoh Aristokratën

15. Ç'është kjo ushtimë Nëno
Mos doli tërë Përdrinia
Të më presë

Apo Nusën ma sjellin
Ç'janë Nëno

Shira-Vërshimë pastaj
Bubullimë-Thatësi-Korba

16. Mos qenka shkruar prapë të endem baladave
Unë Konstantin Arbri i lindur diku në Përdrini

17. Qebesa nuk më përzunë
Për të gjallët më mori malli

1979

SI E KEMI ZBULUAR DETIN

A ju kujtohet detin e zbuluam
kur dhëmbët na u ndërruan

Dhelpra kur harroi udhën
të kthejë në Pyll, a ju kujtohet

Atë mrekulli tërë jetën e kërkuam
nëpër njëfarë uji të zi notuam

Dhe tërë jetën na kërkuan
a ju kujtohet
Atlantida Atlantida Atlantidaaa

A ju kujtohet për në Ilirí
për në Albanopol udhëtuam
me pishë me qiri

Erëra mjegulla ngriheshin mbi Rozafat
e brigjet e varkat askund
a ju kujtohet

Harroni o gjithçka harroni
edhe veten edhe ëndrrën harroni
edhe rënien tatëpjetë Golgotës

Detin e zbuluam kur vjershën e parë
shkruam për lirinë për Skënderbeun

Kur shkollat tona ngritëm
e Dhelpra harroi të kthejë në Pyll
a ju kujtohet

Atlantida Atlantida Atlantidaaa

KRUJA

Krejt ç'është e jotja
nuk mund ta them kurrë
Krejt ç'është e jotja
fillon e mbaron në një mur

E lart shumë lart
ngritur të paskan eshtrat e mi

Fluturon Korbi e shtanget
ngas e t'arrij në kohëra
se krejt ç'është e jotja
në mua e zbulova n'ëndrra

E lart shumë lart
ngritur të paskan eshtrat e mi

Krejt ç'është e jotja
e fisit besimi-amshimi
Krejt ç'është e jotja
zjarmi-udhëtimi-zgjimi

E lart shumë lart
të paskan ngritur eshtrat e mi

Krujë, 1971

SKËNDERBEU

Bëja roje Nuk e pashë
Zbriti bjeshkës
Apo fushës erdhi

Në krah kish një shqiponjë
Të cilën mes nesh
Na e la amanet

Gjergji i Gjonit më thonë
Po më thërrasin edhe Skënderbe
Kur hëna përgjaket

Mori udhë larg e larg nami

Bëja roje Nuk e pashë
U ngjit bjeshkës
Apo rrjedhës së lumit vajti

Kohëve bredh dherave
Në Kështjellë thonë zgjuar rri
Unë besoj: Mbi kokë të Njeriut

Dritë bën Ai

KUR UJI ARRINTE KULMIN E SHTËPISË

Derisa u rrita nëna thoshte
Arriti uji te kulmi i shtëpisë
 Urë e Shenjtë ishte e lartë
 Dhe kërcimet atraktive
 Nga gur i shpuar

Të notoj kur mësova
Dhe kur dola në breg pas shumë vitesh
Nëna nuk ishte më
Veshët plot ujë i kisha
Dhe fytyrën dhe thonjtë plot dhé

Shterur gati ? i rremb i Drinit
Në fund të qenies sime krye qet
Dhëmbë ujku bart pleh rërë
Guxim të jem vetëm a kam më
Apo vdekjen ta ngas Grykës së errët

Në kaltri ngrihet Urë e Shenjtë
Vetëm një pëllëmbë e lartë
Asgjë nuk ka nga përrallat e lashta
Nëna që m'i tregonte rreth zjarrit
Uji kur arrinte kulmin e shtëpisë

NDJENJA

Fatos Arapit

Deti Jon ik nga unë s'di pse
në hapësirë në kaltri më kërkon

Valë e tij kurrë veriu pa e harruar
në jugun e të folmes sime udhëton

E ka diçka në mua që kohëra mposht ka
që Detit Jon i përngjan përrallës

E s'di pse
më kërkon në kaltri në hapësi

Vlorë, 1971

A JU DËGJON HARRIMI

ARBËRESHI DHE DETI

Det o det
I thellë Ti je
Por mua nuk më bie
as në gju

Det o det
I tmerrshëm Ti je
Por unë do të shaloj

Det o det
Hata Ti je
Por unë dua të jetoj

...Dhe deti na ish çarë
Nga klithjet
Dhe tmerri

FSHATRAT ARBËRESHE

Fshatra arbëreshe s'ju gjeta si në poezitë e De Radës
Të Serembes si në kangjelet popullore
si në fjalë të urta të Maurit

Lugjeve të vdekura gjembore kodrave të vetmuara
Larg vetes e botës gjithnjë buzë malit-detit
të derdhura

Asfalti i zi ju sillet si gjarpër rreth kokës së lodhur
ju ha mërgimi TV radio makina ju prishin
drejtpeshimin shekullor
qytetërimi i egër xhezmuzika tamtamet e largëta
ju therrin ëndrrat

Ndryshe pak e kuptoni fjalorin e gjuhës shqipe
ndryshe pak i këndonit këngët shqipe
në një mijë variante brezave u tregoni për
Motin e madh

Arbëreshë megjithatë mbetët

Gadishullit të Apenineve ka sa shekuj atje poshtë
që ia keni vënë shpinën
të mos rrëshqasë në detin e kobshëm të verbër Mesdhe
Fshatra arbëreshe të shkapërderdhura nëpër
harresën italiane

Hora Arbëreshe, 3. XI. 1980

TE DE RADA NË MAKI

Për kokë të lumit vetë e pashë me këta dy sy të mi
të gjallë De Radën

Aspak nuk ish mplakur

Bëmë edhe një fotografi para Kolehhit të Shën Adrianit

Dëshmitarë kam shokët e mi të fjalës

Priste e përcillte te ajo dritare e vetmuar:

Moj More e bukura More

Më njohu edhe me Rinën e Milosaon një Lule mbillnin

(Ata kishin ndërruar vetëm kohë dhe hapësirë)

Bukë e kripë e zemër më shtruan dhe më përcollën në besë

Te një plep vra reje pushova, pak ujë piva në një gurrë

Tepër isha lodhur pluhurosur nga udhë e largët

Pastaj trokita te një kangjele

Aty natën kalova

Ç'shoh: një det i tërë lotgjak ish mbyllur në të

Ngadalë e mora dhe e shfletova

Droja se e lëndoj

Klithjeve fjalëve mall pikonte

E De Rada atje në kodër të përhanë

Vazhdimisht hapte atë dritare të vetmuar

Moj More e bukura More

Kodrave luginave ktheva te Lama: luhej vallja e burrave

Në të zeza gratë këndonin: kur ta shoh martinën varr

Një vogëlush sa Lumi im më tregonte se si gjyshi i tij Serembe
Kaherë kish shkuar atje në Malet Arbëreshe
Për t'ia sjellë atë Mot të Madh
Buzëdetit syçelur i varrosin të vdekurit prapë
Me kangjele i mbulojnë me copa qielli me valëdeti me kripe
Në ëndrra çdo 'i qind vjet ndodh nga 'i tërmet katastrofal
Njerëz të mirë mund t'ju flasë edhe shumë çka e kur të doni
Të gjallë De Radën e pashë me këta dy sy të mi
Aspak nuk ishte mplakur bëmë edhe një fotografi
Dëshmitarë kam shokët e mi të fjalës
Për kokë të Lumit nuk është e vërtetë se ai ka vdekur
Siç shkruan në *Historinë e letërsisë shqipe*
Moj More e bukura More
Këlthet ende ajo dritare e vetmuar dhe e hapur përherë

Maki, 1.XI.1980

VALLE ARBËRESHE

Nuk bën
Gratë të mos kenë rroba të zeza
Rëndë Tokën të mos e rrafin burrat

Nuk bën
Fëmijët të mos bezdisin për Motin e Madh
'i vrap të mos e bëjnë rreth shtëpisë
Para se të burrërohen

Ndryshe
Kënga nuk pikon gjak
Erë mërgimi s'u vjen fjalëve

Frasnitë, 2.XI.1980

IDILË

Për shkak të një arbëresheje
Do të vete në gjueti ujqish

Fjalë kangjele nishana do i lidh nyje për brez
Nuk do të më mashtroj selvi e huaj

Skaj 'i udhe në vetminë më të madhe
Do ta lexoj Bukurinë e Naimit

Për shkak të një arbëresheje
Do bie në gjak e lak e koka në prak

Me valëdeti me erëmalë do të shoqërohem
Me jugun përcëllues të ëndrrave

De Radës e Serembes e Maurit e Gramshit
Do t'ua shtroj udhën me lule atdheu

Anës malit do të shfaqet ajo faqekuqe mollëohrie
Bregut detit do të dal unë rrënjëilirie

Do ta tradhëtoj Nënëen e Trimit qebesa
për shkak të një arbëresheje

ZEFI YNË

Zefi ynë dy herë kyç derën e shtëpisë
Për Ujkun një herë
Të dytën herë për Gjahtarin

Në kulm hap baxhën e tymosur
Pështyn Zotin në fytyrë
Bubulinën Xhavellën përgjon

Në More
Në mes trungjeve në dhé
Dy bojë njeri

Zefi ynë natën e kalon më tepër
Duke vrapuar nëpër shtëpi
Sesa duke i qitur fëmijët në gjumë

Po qe se dera thyhet, thotë Zefi ynë
Shtëpia të mos braktiset
Çelësi patjetër të ndërrohet

Frasnitë, 2.XI.1980

A JU DËGJON HARRIMI

Poetëve arbëreshë

Assesi s'e pranoni humbjen
E kaq vjet erret
dilni prap te bregu i detit
vetëtini derisa bubullon në botë
mblidhni ato të rralla fjalë
ose i krijoni nga hiri i ëndrrave
për një çast ndalni kohën pastaj
kaltroni e zbardheni si De Rada
mbyllni një rreth mërgim derdhni
po a ju dëgjon harrimi deti
dikur vonë ktheheni në kangjele
dhe pritni kohërat t'ju çelin
ose t'u lindë ndonjë zjarr i fshehtë
i Motit të Madh
por humbjen s'e pranoni assesi
e kaq vjet (sht)erret

REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË

ITAKA

Në Itakë
Arrihet në mbarim të udhëtimit
Dhe ora bie gjithmonë dymbëdhjetë

Ata që nisën pa fanar

Nuk mund ta lexojnë kurrë
Librin e shkruar dymijë vjet
Për çuditë e oborrit

Të keni kujdes

Itaka
Megjithatë
Libër i grisur

REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË

Në Janinë hyra
Kur gjethet k'in rënë
Dhe drunjtë zhveshur rreth Kështjellës
Jani në oh Janinë e Ali Pashasë
Si nuk arrita të të shoh
Pyll të ri

Janinë, 1986

FLUTURIM I PËRGJAKUR

Panajot Xhebelikos

Ra këtu A ra
Këtu u ngrit A e pa
Fluturimin e përgjakur të shqipes
Nën Lisin e vrrarë të Dodonës
Mbështillet Gjarpri
Trupit të Çamërisë
E një fëmijë zgjon gurin me lebetitje

Pargë, 1986

BOÇARËT

Antonio Bellushit

S'e k'in 'i burrë për vatër
'i vashë s'e k'in për krua
Të gjithë 'in për mejdan

Atikë e Sul e More
Brendë e jashtë bedenave
Gjuhë pleqërishte arbërishtja

Kiço Noti Marko vatë
Nëpër degë të ullishtave
Fustanella e bërtima latë

Boçarët dhe Lleshi i zi
Mbi shpatë nxin Atika
Epirit mbijnë qiparisa

Nuk i zë asnjë kangjele
Asnjë váj s'i nxjerr fushe
Të paktë e k'in 'i nënë

Kokat ua mori i madhi lavd
Po hije u bëjnë fjalët shqipe
Të thellat të Epirit rrënjë

Fis kapedanësh Boçarët

Misolongji, 1986

SHIU I PARGËS

Parga kur zgjohet rrugicave
Sytë i lajmë në Jon
Ngjitemi te Kështjellë e Ali Pashës
ku na pret dielli

Në kaltri atje poshtë noton Morea
ishull i bardhë

Në ullishtet ilire humbim pas hijeve
Herë duke i prekur majat e Sulit
Herë duke biseduar me perënditë e Dodonës

Në shtëpi të xha Andonit
Kyçim ditën e djersitur në vrapim
Dhe Petriti mëson përrallat e para për Morenë

A është e bardhë babi a është e zezë
A është e rrumbullakët
A është më e madhe se Ulpiana
A është më e lartë se Sharri

Çfarë forme ka Morea babi

Në brendinë time të shurdhët
Zjarri dhe shiu i Pargës
Në mes meje e xha Andonit xhami i thyer

Pargë, 1986

KOHA KALOI AQ SHPEJT PRANË MEJE

Desha të takoj Marko Boçarin
Të takoj Bajronin

Dhe nuk kisha as Shpatë as Kalë

Isha vetëm me arrabaxhinë
Dhe me 'i buzëqeshje të Bjeshkëve të Namuna

Desha të takoj Marko Boçarin
Dhe Bajronin

Por koha kaloi aq shpejt pranë meje
Mbaj mend vetëm emra dhe varre

Misolongji, 1986

URA E ARTËS

Ti na qenke ajo ura që në heshtje të vdekshme
Të kohëve të sërta kënduar të kam im atë
Bjeshkëve të Namuna e krahasuar me Urë të Shenjtë
Urë moj Urë e Artës

Deri te guri yt i latuar nga mjeshtrit epirotas
Udhë bëra vite e vite
Po Hamzë Podrimja nga Gjakova ku arriti
Urë moj Urë e Artës

Lumit tim sa vjet i duhen
Nëpër ty të kalojë me një lulkuqe në dorë
Apo historia jonë shtangu në sqep korbi
Urë moj Urë e Artës

Me një krah në qiell me tjetrin në mishin tim

Artë, 1986

TE GURI I PREVEZËS

Në Nikopol kish pas jetuar Joni i bukur
Joni kish pasur një nënë fort vetmitare
Pas shtatë konaqesh Nëna ia kish gjetur Nusën
Nusja kish udhëtuar e udhëtuar
Joni kish bërë dasmë e krushq të parë Boçarët
Dhe Nusja na kish qenë perri
Dhe k'in filluar fëmijët
Dhe ish pirë verë e shtruar sofra deri në More
Po gëzimi na qe i shkurtër e Mortaja kish rënë
Pastaj k'in filluar luftërat gjaqet hasmëritë
Dhe Joni kish marrë male kish marrë fusha
 E kish humbur Nënë e kish humbur Nuse
 E kish humbur dhë e kish humbur qiell
 Larg larg ish nisur me një Fyell me shtatë vrima
 Dhe një nga një kish shkelur vise qytete
 Peshë kish çuar gurë e dru
Te Urë e Artës Zotrat ia k'in zënë pritën një mot
 Copë-copë ia k'in bërë trupin
 Në degë të një rrapi ia k'in tharë gjuhën
 Në hone të maleve ia k'in shterrur zërin
 Te një ullishte e te një krua ia k'in nxjerrë sytë
Në midis udhe e k'in hedhur
Vdekje e gjallë në mes erërave

Dhe kushedi pas sa vjetësh atypari kish pas
kaluar një udhëtar
Lëshuar kish një namë të madhe
Rrufe kish shkrepur
E ish dridhur gjithë Epiri e Suli
Konop kish rënë shiu
E Jonin na e kish marrë në gji një valë
Aty te Nikopoli
Po syri i tij na ish shndërruar në një copë qielli
Po gjaku i tij na ish shndërruar në një copë dielli
Aty ku ra Joni tregojnë tash
Dielli nxen më shumë
Aty qielli të ruan nga të ligat nga magjitë
E një valë bonjare të humb nëpër guaska ëndrrash
Ç'më la vrapin
Oh ç'm'u këput litari te Guri i Prevezës
Jonin ynë
Mjerë
U

Prevezë, 1986

MOREA

Qiparisë qiparisë qiparisë
dhe qiparisët
emra njerëzish

Kiço	Marko	Noti
Bubulina		Xhavella
	Mjauli	

Vis i çuditshëm i poezisë sime

Patra, 1986

FUSHA E ATIKËS

Idriz Ajetit

Një nga një i mblodhën fjalët
Dhe e thanë një fjali të rëndë
Për pikëllimin e madh arvanitas
U mbyllën pastaj në Fushën gëlltitëse të Atikës

Shpatë – Athinë, 1986

KTHIMI NË ANTIKË

Mensur Raiçit

Ëndërrova një këngë
Hija ime ma ngulfati
Vazhdova të shkruaj një të re
 Në lëvoren e një druri
Pas njëmijë vjetësh po e zëmë
 Kur mori fund udhëtimi i Ulksit
 Dhe kur Homeri hynte në Bibliotekë
 Me Libër nën sjetull
Hija ime
Mbylli veshët qepi sytë
Me dhëmbë të zezë
Vdekjen e vet
Përtypi
 Dhe mua më përzunë
 Nga Morea
 Është e pasigurt hyrja në antikë

BETEJA E ASKUJT

Ismail Kadares

Vasko Popa të tregojë se është poet i madh i popullit
shkroi një poezi më të fortë thanë
se gjithë poezia serbe

por gjithë ajo që frymonte në fjalë në vargje në libra
gjithë ajo që hijonte në kohëra në legjenda në magji
bënin sfida

prandaj Lexuesi mitin e Kosovës e kuptoi
si e ndiente në të vërtetë
dhe si e shihte në mënyrën e vet

U desht një kohë e gjatë për të krijuar poetët
derisa të lindte një poezi
mbi betejën e askujt

dhe rastësisht krejt rastësisht u duk ajo veshur kuq
përderisa Kadareja po kthente nga një shëti
nëpër atë kohë të errët e plot nerva popujsh

LLAPI

Llapi nuk kalohet në këmbë
Në këmbë nuk i bihet Llapit

Dikund pas shpinës së Zotit kërkoheni Llapin

Llapi nuk mbyllet në grusht
Nuk e zë kënga
Nuk e kap kosa
As fut rruza në pe

Llapi shtrihet atje pas shpinës së Zotit

Në Kryeqytet ai bie kur e sa herë të dojë
Prishtina nuk mund të dal as deri në Gllamnik
Nëse Murat Gjaka
Ta shkelë fjalën e fisit

Llapit ik veriu i ziu
Llapit del ujku fushës
Dhe rritet Pylli rreth shtëpisë

Në dritare Murat Gjaka ia mat shtatin
Yllit të largët ia shkel syrin
Shalon atin

'i qind vjet ëndrra plakushe tymon në sy të fëmijës
Pas shpinës së Llapit dikund Zoti mpreh thonjtë

Po Llapi nuk kalohet në këmbë
As mbyllet
Në grusht

NË ZATRIQ

Nesër do bëhet mirë

Nesër do bëhet mirë

Dhe ik dita bie nata

Muaji viti kalon

Shtëpive të llamarinta

Nesër do bëhet mirë

Nesër do bëhet mirë

Fëmijët argëtohen me mace

Flejnë me minj

Gratë me kancer në gjinj

Nën çati morrohen burrat

Zgërdhohen me qiellin e zi

Nesër do bëhet mirë

Nesër do bëhet mirë

Kopila do të ketë më pak

Dhe Prishtina do të dalë në Llap

ELEGJI MUZGU

Babi a kam unë sy

Sy a kam unë

Babi

A kam sy babi

Dhe syri i Burim Burimit

Nga sqep i korbit kish pikur

Në shuplakë të Njeriut

Terri i shekullit e kish fshehur nën strehë

Sy a kam unë babi

II.

Vetëm Ti nuk je

Vetëm është vetëm Zoti

Vetëm Zoti është vetëm

Dhe fishkëllima e kamxhikut

Ti nuk je vetëm

Në Mal do të hante Ujku

KËRKOJE YLLIN

Hape dritaren vogëlush
kërkoje yllin bishtcubel

Hape
nuk uluron Ujku
as Ariu shpellave të qytetërimit

Degëve të Dukagjinit shkund borën
bisht i dhelprës

Hape dritarën vogëlush

Ai që vjen në drejtim tonë
nuk është Emimi
është fatziu

Hape dritaren vogëlush
dëgjoje gurgullimën e gjakut tënd
në pusa të ëndrrave

REK'TIMË

S'di pse më merr malli të shoh Shkupin
E atje s'është Lumi
As Baci Bajram nuk zdirgjet Grykës së Kaçanikut

S'di pse
N'ujëra të Vardarit i fus thellë duart
E më terrohen sytë

S'di pse hapat më ngatërrohen
E shiu më ndjek pas
Derisa të kyçem në shtëpi

S'di pse
Për një mend s'di pse
Shkupi më dhemb në shpirt

E DASHUR

Mbi ballë ma vë dorën e dashur

Derisa të ndjem gjallë
Me ty nuk luhet

Monedhë ti nuk je as figurë shahu
Të kuqet pikla tua në hapësi të bardhë

Mbi ballë ma vë dorën e dashur

Në breg të Drinit ngreh 'i kasollë
Hije e Pashtrikut të më mbulojë

Dhe në shtatë mbretëri farkoj 'i çelës
'i çelës i madh Shtëpisë iu deshka

Dorë e zezë në hapësi të bardhë
Ma vë dorën mbi ballë e dashur

PUSI

Çel 'i pus
n'oborrin tim
Gjithmonë më i cektë

Me vite çel
ujë të ketë me bollëk
për rrënjën time

Nën gjethin e lulediellit
të bëj një sy
gjumë

Pus i thellë në rërë

MBI QENIN

Qeni leh ku han

Po qeni ku han
nuk leh
më

Në Frymë u shndërrua
Kohë hapësi
Mbështjell

Ai qen i mjerë
Që më zgjonte
Nga ëndrrat e liga

PA TITULL

Më iku jeta
Duke ma luajtur Gurin

Njëri djalë vajti me ag kushedi se ku
Tjetri natës ia ndërron këmishën në bedena

Gruaja përkund djepin e zbrazët
Nën rreze të hënës aty në kodrinë
Dhe shtrydh gjinjtë

Unë sillem me një sopatë rreth plepit të mbramë
Te një mur i rrënuar palmuç bie hija ime

Nga burimi i largët
Ujë me grushta sjell Konstantini

Jeta se ç'më iku
Pa ia parë kulmin e shtëpisë

MURI

Assesi ta kaloj / A kalohet vdekja
A mund të iket
Nga vdekja
Zotëri
Shënoj hapësi

Dhe ik / Ka kohë që ik
Nga lëkura ime e puçërraftë

Në të djathtë në të majtë: inercioni
Ra / A ra
E pamundur të humb pavarësinë

Mbet
Vetëm
Hije

Një mur vallëzon / valltar i madh ai mur
i çuditshëm

Vallëzon
një mur
Zotëri

Tekst dyzërash: *Nuk besoj se do të më shohë*
Moti mbath këpucë të ngushta
E tesha të vjetra

Sa vite lypsen për ta kaluar atë mur Zotëri

Tekst dyzërash: *Nuk besoj se do të më harrojë*
Pa mua
Nuk mund të jetojë

Shembet një mur
Ka kohë që e dëgjoj
Egërsirë

LIVADHI

Diku aty ishte shtëpia jonë
Muri i gjyshit dhe Plepi i babait
Hunjtë rreth hapësisë së kuqe

Diku aty zbritnim te Kroi i Dukagjinasve
Shuanim etjen
Bukë e kripë hanim me perënditë e Pashtrikut

Nën kosë rritet tash bari
Dhe mbledhnim dhëmbët e derdhur të ujkut
në shtalbët
E Muri i gjyshit e Plepi i babait e Hunjtë
Lëvizin nëpër kujtime

Unë me duar në xhepa sosi ditën
Duke i rënë hapësirës së shthurur
Dhe dëgjoj hingëllimën e egër të kuajve të shkumuar
Deri natën vonë

Aty midis livadhit ku e kishim shtëpinë tonë

KËNGË SHENDI

Po të ishte sikur Llapi e Prishtina
T'i ndërronin vendet
Dhe çelësat
Natën në kalë do kaloja Toplicës
Dita të më çilte në Kongjel duke i fshirë sytë
Ose sikur Llapi t'ish Prishtinë
E Prishtina pika më e largët në horizont
Në familje më i madhi do isha më plaku
Do të isha ai që isha
Kur isha i ri e i marrë
Apo t'ish Prishtina një lumë i thellë e i gjerë
Gjakovë e Pejë Prizren e Shalë
Në zallishtë të Llapit
Do bënin pëllajë
Pa humbur gjymtyrë do shkelja në Ligë të Parë
Pa thyer krah e brinj
Në hije të malit gruaja gatuan bukëndore
Dhe nuk do merrja Europën në sy
Do të ishte mirë
Po të mos lakohej fare në rasa
Nga nxënësit e këqinj të mos zgjedhohem nëpër kohë
Megjithatë unë nuk jam njeri i pashpresë

Petriti nuk do ma kthejë shpinën si Lumi
Jam supërfuqi
Në Ligë të Parë do luaj prapë
Nuk do të humb më
As në shtëpi

HAPPY END

Në vitin 2013 sipas hixhrit Shpend Shpendi punëtor krahu
në mbarim të verës së fundit të viti 2013
kish përfunduar letrën e vet më të shkurtë në jetë
“Bëra vetëvrasje se nuk dua t’i shoh fëmijët duke vdekur urie”

Kajmekami i Qytetit Diellor me shtatë hyrje kah Olimpi
në praninë e një vejushe e të fëmijëve bonjarë
kish shënuar në procesin e Interpolit
“Vetëvrasje nuk është bërë për shkak të krizës”

Në vitin 2013 sipas kohës sonë djali i
Shpend Shpendit i quajtur Luan
në Memoaret e veta Libri VII kish shënuar
me ngjyrë të kuqe
“Unë jetoj për fëmijët”

Dhe në katin 13 të rrokaqiellit Lumturia të lagjes Dumvenio
pikërisht me datën 13 të muajit 13 të vitit 2013 sipas kohës sonë
kish ndodhur diçka e paparë

Pas vdekjes tragjike të Luan Shpendit në autorelinë
Rreth botës
në bixhoz fëmijët k'in lënë çdo gjë
që k'in trashëguar

Dhe rroqaqielli Lumturia ish shndërruar në një pyll hataje
para të cilit kish humbur forcë
edhe magjia më e zezë

Diku aty rrëzë Olimpiti Kajmekami i Qytetit Diellor
kish marrë kokën e vet në duar e ish mbyllur
në çerdhe korbi
duke i hëngër sytë e vet
e në bardhësi kish humbur Dumvenio

Sipas hixhrit në vitin 2013 e sipas kohës sonë më 2013

BURRËRORE

Kur ia beh e keqja
Udhën lëshoja
Do ta thyejë kokën

Mbuloma qiellin me shami
Të vetmin vëlla kam diellin
Dhe qëndro burrë

Kur ia beh e keqja
Munde me këngë
Vdekja frikon nga bukuria

(i çast më mirë të jesh
Se tërë jetën
Qen)

Bregut të Erenikut
Kaçurrelat m'i krehte nëna
Kur e kishim ngusht
Dhe këngës ia thoshte babai

Kur ia beh e keqja
Gjakut niset e mira
Tundet mali lëviz shtëpia
Qëndro he burrë

TEKSTI YNË

Guri im ka zënë të humbë peshë
për Mur as për Urë
nuk është

Era më e lehtë
vendin ia ndërron formën ngjyrën tingullin

Sëmundja e gurit tim
mos na u bë sëmundje edhe e tokës

Ditenatë rri mbi kokën e tij të gungaftë
prej ëndrrave
prej pagjumësisë

Temperatura e paNjohur
hijen jetike ia shemb
krenarinë

Kot flas qe sa kohë: teksti ynë sintaksë e fortë

HIJA IME

PASTRIMI I SHTËPISË

Gani Bobit

Shtëpia para se të kyçet
Dritaret çilen hapekrah
Shkunden plaçkat
Merren pluhurat
Mbyllen vrimat
Pastrohet nevojtorja
Bëhet xhirimi i ambientit
Zbritet temperatura në zero shkallë
Pastaj në minus
Që të mos qelben trupat

MBETURINA

Nën dritare

Rriten mbeturina njerëzore

Dalngadalë humbet Majë e Sharrit

Dashuria kundërmon erë fëlliqtie

Shtëpia shndërrohet në diçka që s'e hanë

As qentë

UALLT DIZNI

Erdhi koha
T'i lëshojë Macja udhë Miut
Dhe Luani të kyçet në kafaz
Pa nxjerrë zë

Profet ç'na ish
ai Uallt Dizni

Erdhi koha
Të humb udhën
N'oborrin tim
Dhe të mbijnë therra

Uallt Dizni ç'na ish
Profet bir profeti

LETËR MIKUT

Jasha Zllobecit

Po të mos lëvizja
Në Gulag do më gjeje
Ose te Varret e Gjata

minjtë dolën përfushë
Kurtha na duhen kurtha
Uji i zi na mori

Qe përditë ngjitësh
Majë Alpeve
Fundin tim të shohësh

E unë gjithmonë
Ta shkruaj miku im
Letrën time të mbramë

NARCISI

Kurrë nuk e sheh vetveten
Vetëm fytyrës së vdekjes së vet
Vetëm fytyrës së vdekjes së vet i buzëqesh
Dhe kurrë nuk e sheh vetveten

NËN HËNË

Ai rren me të madhe
Dhe para bote krenohet
Unë turpërohem për të
Dhe vazhdoj të vizatoj
Fytyrën e Nënës nën hënë

QENÇE

Në hapësirën shpirtërore
Një qen vrapon të fikë
një yll

Nuk kam thonj
As nuk kam dhëmbë

Nuk kam sy
As nuk kam vesh

Frymoj përmes varrëve

Majë bishti
Vdekjeprurës iriçi

Më hodhën midis udhe
Kur kafshova qiellin

Tani më bien
Nga të gjitha anët

Edhe kudra ime më shkryen

UNË JAM EGËRSIRË

Una kam shpinë të fortë Zotëri
Këmbë të forta më të forta seç mendon ti
Dhe të shpejta
Sa çil e mbyll sytë kaloj kodrën ku rri Zotëria jote
Në dhé deri në gju këmbët e mia zotëri
Njëqind vjet një mijë vjet mund të bart
Mund të bart deri atje ku perëndon
dielli yt e nis dita ime

Deri deri
Deri atje te Varri
Shpinë të fortë kam Zotëri
Të forta këmbët të shpejta rrufe
Mund të ndodh e të bie në bërryla në gjunj
Por ty do të bart Zotëri deri te tempujt e tu të mykur
Shtëpia ushton
Nga fjalë të reja me forma të vjetra
Dhe droj për shëndetin tënd Zotëri
Për fjalët e tua për refrenet monotone të këngës sate
Për mullinjtë e egjër që bluajnë edhe mut
Droj se do të rrëshqas keq Zotëri

Në shpinën time të gungaftë rrëshqitet hatashëm
Dhe do të mund pa hedhur topin në fushë
Me kokën tënde futboll do lozin fëmijët
Unë kam shpinë të fortë a po sheh Zotëri
Këmbë të forta thellë në dhé
Deri në fyt jam në dhé Zotëri
Por ty por ty do të bart deri atje deri atje
Deri te Varri i sulltanit tim të verbër
Unë jam egërsirë

NËSE

Nëse 'i popull
Nuk i ka poetët
Dhe poezinë e vet
Për një Antologji Kombëtare
Mjaftojnë tradhtitë
E lehje qensh

PASQYRA

Zbathi këpucët
dhëmbët i pastroi
hapi dritaren

Ndot

Në pus syri iu shndërrua
ëndërr apo zhgjëndërr ish
Korbi i Posë

Nga flokët shkundi vitet
dushin lëshoi
avullinë

Ç'kafshë e përbiu

HIJA IME

Hija ime më mashtron
herë me orë nuk e mbërrij
herë fare nuk e hetoj

Ç'po ndodh me mua zotynë

Në horizont dielli sapo duket
zë në thua e bie diku
përtej hapësirës së bardhë

Unë sillem rreth vetvetes
po hijes sime besën nuk ia kam
Ta marr apo ta lë

FAJTOR ËSHTE SHQIPTARI

Fajtor është shqiptari
që merr frymë
e ec në dy këmbë

Unë që pi medikamente për qetësim
e tërë kohën gjuaj miza
në Nevojtores

Fajtor është shqiptari
që shkryen gruan e vet
e familjen time shqetëson

Dora ime Mollën që s'e arrin
në degën më të lartë
me fjalë të vdekura që mbushi Pusin

Fajtor është shqiptari
që s'ekzistojnë më shumë Turqi
më shumë Amerika e Norvegji

Gulagu që është aq larg

Që më zgjidhën e më lëshuan
të nuhas pas tij
A nuhatet vdekja

Fajtor është shqiptari
më shumë që nuk ha
e nuk fus gjumë në sy

Kanalizimi ynë që plasi
e Katakombet e Ballkanit
u rrënuan

Fajtor është shqiptari

që vizaton fytyrën e vet nën hënë
e thyen dritare e trazon ujin e ndotë

që flet shqip që ha shqip që dhahet shqip

Fajtor është shqiptari
shqiptari është fajtor
për të gjitha rëniet e mia

Edhe për dhëmbin tim të prishur
edhe për buzëqeshjen time të ngrirë
prandaj prandaj PLUMB

Ha ha ha
ha ha
ha

Fal të qofsha Zoti im

ZARI

Rilindja, Prishtinë, 1990

UDHËT

Dy udhë ekzistojnë në jetë

Njëra shpie në Kopsht
Në Nevojtoe tjetra

Në Kopsht lëviz Gjarpri
Uji i Zi në Nevojtoe

E ti miku im i urtë
Zgjidh cilës të shkelësh

KUJTIMI PËR NËNËN DHE HËNËN

PISHINA

Më hodhën në pishinë dhe më thanë
atje në fund flen Peshkaqeni

Te Ura e Tabakëve më shpuri Nëna një verë
pastaj Babai më mori për dore
deri te Ura e Shenjtë

Poshtë atje lëvizte Peshkaqeni me sy terri

Uji do ta kapërcejë edhe Malin

Pishina nga betoni zmadhohej deri në pafund
e Peshkaqeni me sy të përgjakur
kafshonte Hijen time
dhe Mollën e Nënës

Vonë kur mësova të notoj i kisha njëqind vjet
dhe isha një torzo i pikëlluar
në Muzeun Kombëtar

Në fundin tim kisha zbritur shkallëve
atje te Ura e Artës
dhe turrja vetminë

Ka sa kohë që shikoj me sy fëmije
Peshkaqenin si lëviz mbi syprinë të Ujit të Zi
në pishinën nga betoni

Me siguri do ta përjetoj edhe vitin tim të njëmijtë

MOLLA E NËNËS

Nuk isha zgjuar ende
në pjtë dheu kur pikë
Mollë e Nënës

Qe rri aty te koka ime e hutuar
dhe drita ia zbulon formën e mrekullueshme
Më shikon thua se më thotë
Do të më qafosh apo kafshosh

Gjatë e marr nëpër duar
e pastroj me shami martese
me kujdes e mall

Ajo shkëlqen edhe më
dhe buzëqesh
Unë ngadalë nis e shndërrohem
në bërthamë të saj

Kur tashmë e pushtoja edhe nga brenda
shkëlqimi i kuqremtë
mbuluar më kish të tërin

Oh zot
e qëroja dhe e copëtoja
pa fije mëshire

Nëna a do të më kujtojë më

KUJTIMI PËR NËNËN DHE HËNËN

Hëna kur dilte maje Çabratit
Nëna më thoshte:
Doli motra jote në dritare

Shaminë merrja dhe ibrikun plot ujë
Zbathur nisesha kodrës së blertë
Ia fshija sytë e përlotur
Ia fshija faqet e zbehta

Kur Hëna zhvishej
Dhe humbte në ujëra të Erenikut
Lëshohesha tatëpjetë Çabratit
Me fustanin e saj të grisur

Nëna mbyllej në vete

Gjeja pastaj çekiçin e babait
Qetësinë e padurueshme thyeja
E mëhalla curronte veshët lapoçë
E mëhalla i lutej Zotit

Nëna buzëqeshte atëherë:

Pluhur kur çohet pas teje o bir
Di se je pjella ime
Di se je gjallë

Një mot Nëna u shndërrua në zog
Dhe mbi çatinë tonë u shemb qielli i zi
Mblodha dikur fjalët e saj të shpërndara
Kalli vetëm mora botën në sy

Maje Çabratit thonë Hëna s'del më
As nuk zbret në Erenik
Ndoshta Nënës ia ndrit udhën

MOISIU I MALIT TË SHENJTË

Rrokullisesh Malit të Shenjtë
kokën s'e çan askush
bie a zgjohesh më

I tepërt i huaj i mallkuar Jesu

Sa çel e mbyll sytë
njëmijenjë çudi
po Muri më i fortë se ti

Dënuar je të zbresësh
në hapësirë të zhdukur

Të mbledhin të pjesëtojnë
sipas qejfit

Të shpien te Pusi i Akullit
Verbëri gjaku vizullima

Kafshë e mjerë na argëto
Dhe të shtyjnë dhe të pështyjnë
Olimpit tatëpjetë

Gishtat futi në vesh sa të duash
Shqirru vdirru hidhu
as të sheh as të dëgjon kush

Ani ani besomë pakëz Jesu

Rrokullisesh Malit të Shenjtë
ajme ajme
Moisi

KËLYSHI

Te Lisi i Shituar u shfaq
mbuloi Malin me shputë
Udhën fshehu pas shpatës

Ndërrova zotëra unë
kohët ndërrova golgotës
derisa gjeta Shtëpinë

Tevona hap syrin tim të djathtë
veshin tim të majtë shurdhova
Me poezitë e mia zgjohej e binte Ai

Rrethit kur doli Dhelpra
minj u mbush Shtëpia
Mali vdiq nga cungat

Biri i bushtrës veshët curroi
te Lisi i Shituar
thonjtë nguli në Mishin tim

Qen na ishte bërë këlyshi

DUKE LEXUAR
PIKËLLIMIN E HANA D.

Iku Gjyshja
Një ditë hataje pastaj
shëndenë na e la edhe Nëna
Ujit dhe Bukës dhe Kripës
nisa t'u them ndryshe
Tani botën dhe veten
artikuloj në gjuhë të Njerkës
dhe në mua zhduket
diçka përrallore
Edhe lindja edhe vdekja
peshë tjetër kanë
dhe vazhdimisht më bëhet
se Zoti im
është i zi
Zot mos i thashin

KORONA*

K. Xukaros dhe I. Fortinos

Rrjedh një lumë në ëndrra
lumë i bardhë shpirtkëputur
ai është lumi ynë Korona

Rrjedh një lumë nëpër kohëra
lumë i zi gjamë fisi
ai është lumi ynë Korona

Varret atje i lamë dhe Zotin tonë
po fëmijët po fëmijët
si do t'i rrisim pa Koronën

pa bekimin e të Madhit

Koçencë, 1988

* Korona – lumë i shenjtë i arbëreshëve në More

KUSH DO TA VRASË UJKUN

F. Altimarit

Dhe lëtini tha

Po qe se takon
Arbëreshin dhe ujkun
Vraje Arbëreshin

Dhe kur fjala i ra në vesh
Arbëreshi buzëqeshi
Dhe drodhi një cigare

Po qe se më vret mua
 more i gjorë
Kush do ta vrasë
Ujkun

Mjerë kopeja

Koçencë, 1988

HORA E ARBËRESHËVE

Xb. Skiro di Maxbos

E largët
dhe
E lartë

Ku njerëzit
bëjnë
punë zotërash

Hora e Arbëreshëve, 1988

KËNGA E MËNGJESIT

MINJTË

Midis dhomës sime plasi diçka befasuese
Mbi çdo gjë të gjallë e të vdekur ra terri
Në brendinë trishtuese humba flokëpërgjakur
Në mes minjve që vërtiten kah pika vizulluese
Nga skaji në skaj çmontoj mure të çara
 mbyll vrima me shuplaka të nxira
Ç'është e mundur nga jeta ime të shpëtoj
Biri i botës sa çel e mbyll sytë udhën kalon
Që tërë jetën s'do të mund ta bënte një maraton
Zgërdhohet dhe yjet
 bien strehëve të lodhura nga myshqet
 dhe Shtëpia pikon në të katër anët
Në peizazh gërditës shndërrohen flora dhe fauna
Në pikë verbimi shkrepëtijnë dhëmbët e verdhë
 dhe sytë e mavijosur
Ja edhe në mendim edhe në intimitë edhe në poezi
 arritën të hyjnë këto krijesa të neveritshme
 e kohë qershish është
Nëpër dhomë tash e sa kohë kërkoj Familjen time
 të bërë pikë e pesë
Në lëmë thish na u shndërrua ajo A s'i merr erë bykut
 më shkruan Nëna nga Planeti i Lumturisë

Dhe kot zëri im pirrohet mureve të çara
nga vrina del miu dhe pa fije turpi i ziu
 kërcen mbi këmbën time të shtrirë në arkivol
 pastaj mbi dorën time të gozhduar
 ngjitet kah koka ime e qethur
 dhe grimcon tmershëm në pyllin e lebetitjeve
Mos harrova athua të kurdis orën e babait
E ti vë shulin derës së shtëpisë
Kur rashë të flija

IMAZHE NGA QYTETI I DERDHUR

Eh *barbarët* për të satën herë pëshpëriti plaku Hysen Xh.
Duke mbyllur Librin e Urtisë e hapur dritaren
Pëllëmbë pëllëmbë mati hijen e Sharrit dhe
kurdis orën e vjetër të familjes

Tmerrësisht gaboi Kavafis *barbarët* që s'i la aty ku ishin
më pak do të kishte zotëra varre

Para tij nuk di prej kah u rrokullis një gur
Mur pas muri u shembën pastaj derisa hataja gëlltiti ëndrrat
Dhe Porta e lashtë hapi krahët kah qielli i zgurdulluar
oh ai zog pikëllues prej druri

Plaku Hysen Xh. për herë të parë pa lakuriq
Qytetin e përrallave duke e fshehur trupin e kafshuar
Diç shkrepë në syrin e tij të shterur e përrë përrë u thye
Shkëlqimë e hatashme mbuloi sende shpirtra

'I ditë u nis kushedi se ku me një fotografi të llahtarshme
dhe me qytetin e derdhur në shuplakë tharë motesh
Zot nuk ka Zot nuk ka tregojnë deri vonë rektimë
e tij trandi dhe e fis

As i verbër as mondan erdhi dikur një poet flokëverdhë
Shpatijeve të Sharrit këputi një lulebore
Në hapësirë të zhdukur kërkonte varrin e plakut Hysen Xh.

Tmerrësisht gaboi Kavafis *barbarët* që s'i mbylli
përgjithmonë diku në Librin e Urtisë

ODË ANTEU

Mashtrohesh se mund të bësh çkado me mua
Brenda hijes sime udhëtimi yt mbaron gjithmonë
Çamçakëz pse përtyp s'do të thotë se jam kalama
Kur të dua ta qëlloj mollën maje bajrakut
Në mënyrë fantastike si murtaja hapet kërpudha jote
Mbi gjithçka timen dhe m'i fsheh diell e qiell
 Rrënja ime nëntë herë i bie botës
 brenda 24 orëve e ti teksa del gëzhhojës
Mbi kulmin e kërrusur kërkoj yllin e mëngjesit
Në titërr të lëndinës vjell shkrumin e ëndrrave
Nga lëkura ime pagane shkund dhëmbët e tu plot dergjë
Pasmesnate bie në ahishte e i laj duart në puse lotësh
 Dal në fushë dhe e hedh farën nëpër hënë
 Shkoj në mal e kthehem pa kal'
Në krye ode vë fotografinë e Nënës
Me muzg bie e ma heq e me terr m'i ndërron rrugë e këngë
Rebelimi të zbutet edhe më ulërin udhës së vdekur
E mbi kokën time lëshohen sorrat e dhihen e krrokasin
Rrethit të viteve vetëtin fytyra e Nënës
Dhe sytë e shkrimbur të fëmijëve të harruar bodrumeve

S'do të thotë se unë jam kalama pse përtyr çamçakëz
Maje bajrakut ta qëlloj mollën kur të dua
Me mua mashtrohesh se luan koc i fortë jam plakush bre
Gurë e dhë lëvizin pas qerres sime të zjarrtë
Hapen udhë bien mure dhe hije dhe merimanga
Shpirtin ma kthejnë fuqinë ma kthejnë
 A dëgjon kërmill
 Oh zot

JASHTË VETES

Ç'do të bëni
kur të hyjnë në Ujë të Madh
Do të zëmë morra
E pastaj
Prapë do të zëmë
edhe më shumë do të zëmë
Por kur të sosen morrat
a do t'u bini fyejve
a do të këndon
Do të morrohemi
E pastaj
Do të na morrojnë sipas qejfit
Dhe
Dhe bota le t'i krehë flokët
para se ta zgjasë qafën në cung

INTERMEXO

Fillim kur s'ka
S'do të ketë as mbarim
Sidoqoftë kurseni kokat
Vezullon shpata

KËNGA E MËNGJESIT

Pa kurrfarë faji më goditën
të mos zgjohem më
Megjithatë ferku
ma ledhaton fytyrën e zbehur
ma hap syrin e shkyer
Dhe shoh gjelin e kuq
duke u zgjuar bukuroshen e fjetur
në degë qielli

BALADË PËR NJË QEN

Leh
vetëm leh
dhe sheh
vetëm një dru
e vite ka
që humb në Pyll
pas zërit të vet

DIELLI LIND NË PERËNDIM

MOLLA NË DEGË

Armiku yt më i madh
është varfëria miku im

Lehtë ia bëjmë urrejtjes

Shoh
Dora jote s'është e vogël
për ta këputur mollën në degë

TEË DUAN LUMI

(variant)

Të duan Lumi
kur ti hesht
kur ti nuk kërkon asgjë

Kënga jote e pakapshme
për veshin e trashë
Të tmerrshme shkronjat e tua
dhe Poeti yt dhe vrapi yt

Sapo harron
Dy herë dy
mund të bëjnë edhe katër
ta luajnë gurin në hapësi

Dhe të duartrokasin
kur ti humb
Lumi

FËMIJA VDES NË BODRUM

Do të zbres njëherë atje poshtë
me pishë në dorë

Fëmija vdes në bodrum
a dëgjon Njeri

Bukë e Kripë do t'i ndajmë bashkë

Duart e nxira këmbët e akullta
trupin e mavijosur
do t'i marr ngrykë

Me hukamë e urata do t'i mbështjell

Në bodrum vdes heroi i shekullit tim

Do të zbres njëherë atje poshtë
me pishë në dorë

Me minj me terr me shpirtra të shoqërohem

Shoku im i vogël vdes
a dëgjon Njeri

E perënditë e rrejshëm grinden
kush do të ketë
hapësirë më të madhe për varr

KONTEJNERI

Nën çatinë time humnerë e llahtarshme
Minj të coftë plehra xhama të thyer
qese najlloni
myku i botës

Dhe vinin dhe i bartnin përtej varrezave

Zbresin tani aty fëmijë të uritur
fundin ia qesin tërë ditën
derisa lodhen ose i zë gjumi

Me vijë agimi dalin dhe
bashkë me minj me plehra me xhama
i bartin me terr qerret e zeza

Nganjëherë vetëm zërat e shtjerrë
ua dëgjojmë
vetëm gjishtërinjtë e përgjakur ua shohim
kah dridhen për herë të fundit

Dhe roletnat lëshohen rrëmbimthi
dhe lagjja kalon edhe një ditë të krizës

Humnerë e llahtarshme
po pres të pikë edhe qielli
në fytin tënd kapërdisë

ZOTI TË DHASHTË

Rreth kokës më vërtitet bota
Fundin ende nuk ia di lojës
Derën shpesh harroj shtëpinë
Harroj Lumin e selvinë pa ujitur

Duart më tmerrojnë të zgjatura
Trotuareve e bredhjet Evropës
Pranë një fëmije pranë një nëne
Si mund të kalohet *Zoti të dhashtë*

Kur një kore bukë heq më rëndë
Se një planet kur sillet Rrota
Furishëm e vlen më shumë se një jetë
Ç'kuptim ka ekzistenca liria

Në pasqyra ti që humbesh në mermer
Dikush në shpirt a mendon se ngrin
Se dikush vdes urie durimi në bodrum
Apo vetëm ha e pi e dhiesh laro more
qeni ynë

Shputave të mia lëkurë e re doli

DHOMA 512

Prapë në dhomën 512
Ndryshuar nuk paska asgjë
Këtu je ti Lumi
 dhe Fryma jote
 më e fortë se muret e larta
Ti je këtu dhe dhoma
 plot ne plot ëndrra
Maje gishtash kaloj hapësirën
Droj se ta lëndoj shpirtin
 gjymtyrët e derdhura
Nuk bie as nxjerr zë
Edhe këtë natë trishtuese
 pranë dritares
Ditët as vitet tua
Nuk dua t'i numëroj
 fshij fjalën vdekje
 nga Fjalori i Ri

Beograd, 1984

NJERIU I URTË I DRINISË

Nuk më qiti asgjë
për të ngrënë
as për të pirë

Ish i varfër sa s'bën më

Rreth zjarrit
ndërruam fjalë
derisa zbardhi

Dhe isha njeriu
më i lumtur
në botë

Eh njeriu i urtë i Drinisë

LETRAT

Sh. Maliqit

Dhe më shkroi
më mirë të kisha shkuar
me kohën time klithjesh vezullimësh

Dhe i shkrova
A po sheh
ka edhe më keq

Baraz tani jemi miku im

Ndaç ia nisim nga fillimi
ndaç dëgjojmë muzikën e rëndë të vetmisë
kah pikon mbi koka tona

DIELLI LIND NË PERËNDIM

Oxhakun qysh se e ndërruam
në Perëndim lind dielli

Kush kohën e kalon në kontejner
Kush Zotit ia lëpin thonjtë

Nga mëngjesi në mbrëmje
rrah hekurin e skuqur në rreze hëne

Motor të ri për makinë të vjetër

Me hëngër me pi do të ketë thonë

Por Bukë e Kripë e Zemër a mjafton
kur Besa na u bë trup i huaj

Të mjerat fjalë që hani vetveten
nën çatinë time të kërrusur

A GJUHEN PËLLUMBAT

DALLIMI

Dallimi në mes
Deles së Zezë dhe
Deles së Bardhë
është se

Delja e Zezë
hetohet nga larg
dhe hyn e para
në kasaphane

Kurse Delja e Bardhë
lutet të ketë
pjellë të mbarë

Dhe të kthejë Gjahtari
nga Pylli i lebetitjeve
me Lëkurën e Ujikut

KUKULLAT

Nuk më shqetëson asgjë sa kukullat
Shoh: Dhoma e Petritit na u bë tepër e ngushtë
Për trupat e pashpirtë

Hatashëm lëvizin kur llamba ndizet
Deri në një bien kur erret
Dhe memecëria derdhet gishtërinjve

Mbyll derën dhe dëgjoj Petritin
Në emra perandorësh
Duke i thirrur

Njerëz as kafshë nuk janë
Asnjë pasqyre s'ua zë fytyrat
Para dritës dridhen si hije

TATËPJETËS

Vetëm njëra anë dëgjohet
vetëm njëra dritare hapet
 Po Dielli pikë diku ngjeti

Kur të dëgjohet ana tjetër
ana tjetër a do të shurdhohet
 a do të mbyllet dritarja e zgurdulluar

 Dielli a do të pikë edhe në çatinë e kërrusur

Dëgjohet vetëm njëra anë
vetëm njëra anë
dhe gishtat në veshë dhe fishkëllima

Kur të dëgjohet ana tjetër
a do të harrojë njeriu të lehë
 a do ta zëmë Diellin tatëpjetës

A GJUHEN PËLLUMBAT

Pëllumbat a gjuben bre?

Ulem në rend të dytë
pse shoh më larg
e dëgjoj më mirë
pse kam zë më të fortë

Vetveten s'e ha nga mëria
as shtyhem me brryla
Më shlrë e kam se në rend të parë

Si gjuben pëllumbat bre?

Nga karrigia ima lëvizëse
për mrekulli mat kokat tullace
dhe barqet e fryra

Është rrenë e kulluar
se unë Ali Podrimja
jam qytetar i rendit të dytë
në Planetin Ka Ka

A gjuben pëllumbat bre?

Mos e dhashtë zoti
t'ulem në rend të parë
me gurë varresh
as t'i gjuaj pëllumbat

EKLIPSI

Një të mirë e ka e keqja
Askë nuk e lë të qetë
Ja edhe gurin e lëshoi durimi
Me ëndrra a kalohet jeta

MË JETOHET

Lehin zoti im lehin
e unë s'kam fjalë

Për tokë kapem
Mbahem për qiell

Lehin zoti im lehin
e mua më jeto het

KUR I MUNDA ZOTËRAT

Ti s'di asgjë miku im

Pse unë këndoj
kur ma shkelin hijen

Pse pikon vetmi
nën strehën time

Pse sytë më zmadhohen
në pikë dite

Ti s'di asgjë miku im

Kohët keq të mësuam
kur i munda zotërat

deri në një

KU VEMË

Kaq rren
Sa s'i besohet
As së vërtetës as vetes

Ku vemi
E kush na lan
Turp i zotit

NGJITJA KAH MAJA

GJAKU I SHPRISHUR

Nesër është festë e poezisë

Mate Sinani dhe unë
Plakim ditën në një hotel të Bosnës
Dhe shpikim shishen e mbrame me Skënderbe

Josif Bageri na ishte i anës sonë
Dallimi në mes tije e meje është
Ai Evropës ia shpaloi shpirtin tonë
Pakëz kaltri unë solla nga andej

Dhe Mate përkthen në gjuhën maqedone
Poezinë e parë nga *Lum Lumi*

Mësuesi im Agim Mulliqi e kishte zakon
Varrezave të Sanxhakut të shëtiste deri vonë
Mësuesi im i ndjerë nuk do të besonte
Në serbokroatishte të dalë një ditë Ovidi
në përkthim të S. G. nga Golia

Në hotelin e boshatisur ndiej frymën e shiut
Dhe si e zënë ethet poezinë e lindur papandehur

Mbi tre poetë të një gjaku që në Takimet
Ndërkombëtare
Jetën do ta thonë në gjuhë të ndryshme

Njëmend nesër do të jetë festë e poezisë

Sarajevë, 1984

REKTIME PËR NJERI

Nuk ishte nga ne
Asgjë tonën nuk kishte

Ishte veshi i huaj
Zezona e ditës në thua

Copë thëngjilli harruar
Mbi ëndrra fëmijësh

Korbi mbi Kroin tonë
Mjegull ujku ishte

Nuk ishte nga të gjallët
Gur varri hijalli vetë

Ndanë udhë u ula
Dhe sytë m'i lagi 'i re shi
oh njeri

Rrahja tokën puthja hirin
Zi mbillte farë e truar

FOTOGRAFIA NGA FAQJA E PARË

E pashë në faqe të parë
të zezët dhëmbë i shkrepëtinin xixë

Në ekran e pashë në mes bokserëve
në mes lareshave në mes huliganëve

Derisa zbardhi në time frëngji
e dëgjova në radio

Shesheve rrugëve ulërinte kafshë e zezë

A do ta shoh në shtyllë turpi
në faqe të fundit

KUR DO TË FLASËSH O ALI PODRIMJA

Në shuplakë fiket ylli
na shikon në sy dhe përbihesh
shpinën pa na kthyer asnjëherë o ali podrimja

Rri atje nën qiellin e ftohtë dhe hesht me vjet
beson ende
në njeri

E emri të falsifikohet
mbiemri nënshkrimi datëlindja
emri i nënës i babait i vendlindjes i të parit

përrallat fëmijërore vallet lodrat
heronjtë këngët vajet kremtet

Mbi gjuhën tënde të lashtë mbi fisin
shqirren
dhe derdhen përronj të zez

E ti hesht o ali podrimja
beson ende
në njeri

Në hone të errta në bodrume mesjetare
elaborate emërtime të çuditshme rrëtime
mallkime
lehje ndjekje kyçje
gjueti e egër

Ndizen fiken qirinj erë temjani pikojnë fjalët
trupat rezervati
nën sjetull të fatit dheun marrin fëmijët
Gruaja end e shkreh pëlhurën
në Kullë letre

Mbi kokë zgjatet hija sorrat korbat qiellit
kaçurrelat e verdha kreh
me një grusht dhé në gji
nisesh larg larg

Në Evropën mondane je *albanais*
arbëresh në Itali në Greqi *arvanitas*
arnaut në Turqi hamdurlah
në Amerikë mish konservash
e asgjë tjetër
e asgjë tjetër

Kushedi sa gjuhë flet zoti yt

E ti hesht o ali podrimja
beson edhe
në njeri

Por por
kur do të flasësh o burrë i dheut
apo më parë *dubet të lindësh*

Kulmin tënd ç'e mbulojnë myshqet

NEVERIA

Ndez radion
Ulërim pylli në dhomë

Shfletoj shtypin
Sa s'më kapërdijnë kafshët

Fik TV pastaj
Dhe shtrëngoj grushtat

Athua qenkam kaq i tmerrshëm

DALJE NGA RRETHI

Gjarprin qëlloje në kokë
Bishti është vdekjeprues
Peshoje atëherë lirinë
Nuk ka gjë që të zhduk

KATRENË

Ai që ia kthen shpinën popullit
Herdokur do të bjerë në gjunj para tij
Populli nuk harron as nuk fal
Gjykimi i tij secilin e arrin Mjeri ai

NGJITJA KAH MAJA

Nuk më duhet makinë e shpejtë
Më duhet makinë që do ta kaloj
 udhën time i sigurt
Dhe vetë të jem timonier
Përrallë e moçme është se Akili
 do t'ia shkojë Breshkës
Flakën jua sjell nga maja e pushtuar

THELLË NË NATË

Syzat vëri
Kur kalojnë njerëzit
Jeta lexohet nga brenda
Kafshët gjithnjë e më shumë
Na prishin ëndrrën
Thellë në natë

DIKU NË BOTË

Po qe se nuk të shkruaj
miku im i dashur dhe
po qe se nuk ma dëgjon zërin
merr një karafil
e ma kërko varrin
diku në botë

ZARI

Të bëhet
Se je fitues
Veç ti ke hyrë në lojë

Të bëhet
Se dole në breg
Uji të ka bartur kushedi se ku

Të bëhet
Se jeton më në fund
T'i i harruar tashmë nën bli

Zari është art
Ai që e hedh
Ndan edhe humbjen

QËNDRIMI JETË-E-VDEKJE-PËRQAFUAR

*Më pat lindur vend i zotit
E bëj punën e njeriut.*

Lasgush Poradeci

Me rastin e leximit të parë të vjershave të Ali Podrimjes *Lum Lumi*, kuptojmë mirëfilli se në dredhat më të koklavituara të jetës është pikërisht poezia ajo që gjen një rrugëdalje. Me rastin e leximit të dytë mendojmë se përnjëmend për një poezi të këtillë mundet dhe duhet të shkruhen njëqind libra të tjerë. Me rastin e leximit të tretë na imponohet konstatimi se ajo është meditim poetik mbi jetën dhe vdekjen që s'mbahet mend me fuqi dhe bukuri të thënies e shprehjes në poezinë shqipe që nga fillimet e deri më sot. I nxorëm këto tri aspekte si pikënisje të shqyrtimit tonë.

Vdekja, njajo temë-tabu e historisë së invadimeve dhe e shkeljes së dinjitetit të njerëzve veç e veç dhe të popujve të tërë, që shërbente për frikësime për botën e përtej varrit dhe për të mbuluar ekleziastët me velin e misterit të gjithpushtetshëm, që i shtonte rrudhat e ballit, pagjumësinë dhe kokëdhimbjet e filozofëve të të gjitha kohëve dhe racave njerëzore, që rrëmbeu dhe rrëmben gjithnjë rend e pa rend mbretër dhe lypësa, engjui dhe kriminelë të lindur njësoj në vendin e zotit siç thonte Lasgushi, që lë zbrastësi dhe papajtueshmëri në shpirtin e njeriut – kjo temë

e stërekspluatuar në historinë e mendimit njerëzor këtu konceptohet si katarzë, kalitje dhe kushtrim (kush-a-trim). Ali Podrimja nuk shtron pyetje retorike, nuk lëshon klithje dëshpëruese, nuk jipet pas dhimbjes së pikëllimit, nuk përbrendëson hatanë e quajtur vdekje, nuk kridhet në metafizikë. Në këtë poezi vdekja nuk është trajtuar si abstraksion e alibi për të munduar veten në paaftësinë për të zgjidhur enigmën e jetës; ai vdekjen nuk e vështron si absolut të jetës, as si totalizim të së vërtetës mbi tragjiken njerëzore. Këtu me rastin e vdekjes së burrit disertohehet për burrërinë, babai dhe poeti e vështrojnë të birin dhe krijimin, e shikojnë me sekonda, me minuta, me orë, me ditë, me javë, me muaj, me vite që ngjan se përjetohen si shekuj, se si pakngapak dhe mizorisht, vetullat e qepallat, thonjtë e dhëmbët dhe mishi i gjallë biejnë më ngadalë se flokët në jetën fare të njomë, se si jeta ende pa u bërë pjekuri bëhet lehonë, se vdekja nuk është vdekje por lindje e vlerave të reja, të njëmendta, njerëzore, se mizoria e infektive, e rendit shtëpiak, e duarëve të ftohta, kjo ironi e jetës kthehet e bëhet jetë, durim e qëndresë. *Telefoni i zji* dhe *vaji i përmallshëm i fyellit* dikund në këto anë, ankthi e dhimbja nuk artikulohehen dot se janë përzierë me ëndërr për jetën; se afazia e poezisë shndërrohet në mit dhe miti është lindje e re, poezi. Kotësia e njeriut është shushatje, zot ka apo s'ka, nuk ka nuk ka, tmerr i jetës mizore që vetëm krijimtaria ia heq mizorinë. Në zgripç të jetës është pikërisht jeta ajo që triumfon.

*qe prap lëviz syrin
hap veshët
shtrëngon dhëmbët*

kjo tragjikë e jetës e cila fare gabimisht quhet vdekje, këtu kërkon të pagëzohet *durim guri*. Këtu përjashtësohet tmerrri para vdekjes dhe madhërohet afshi për të jetuar.

*Unë nuk qaj
shi bie
voglushi im
shkundet plepi i shtëpisë*

pikëllimi kthehet e bëhet ringjallje e vargut të fuqishëm që e tejkalon dhe e neutralizon tmerrin. Është këtu një vrull i hatashëm njerëzor: kush nuk ka arritur njëherë të mundë vdekjen, ai nuk ka jetuar fare! Këtu pavdekshmëria nuk është iluzion i ikjes nga defetizmi për t'u futur në legjendë, por qëndrim burrëror ndaj vdekjes që inicon një mësim për jetën:

*Ike
nga dëshira
për të jetuar
por
të gjallët
ende s'i le të qetë.
Trimat nuk vajtohen
Paç dritë në mbretërinë tënde
të humbur.*

Individi-që-shket-në-kolektivitet

Në poezinë e Ali Podrimjes s'është koha e individit. *Tmerr tmerr* kthehet e bëhet *lum lumi* këtë herë, sepse poezia burrërore kthehet e bëhet poezi atërore, se atë e bir janë të fisit. *Ishe shok i madh i njeriut*, thotë ai. Në këtë poezi-shtëpi-e-vdekjes-katarzë lexuesi hyn jo për kryeshëndoshë, po për pleqërim ku duhet të pajtohen gjaqet rreth pastërtisë njerëzore dhe e gjithë kjo të kthehet në bukuri poetike; lexuesi hyn këtu jo për ngushëllime, po për solidaritet, për inkurajime. Si këngë për trimin-e-madh-me-shokë-shumë kjo poezi është ekzigjente ndaj lexuesit, të cilin e angazhon si kokrijues e bashkudhëtar drejt jetës e drejt vdekjes, me fatin e vet në duar të veta. Kjo është paradoksalisht poezi e

tmerrit jo vetëm në fragmentet e jetës, por edhe në tablo të tëra që vetëm në shikim të parë duken si torzo¹. Edhe ky libër i poetit paraqitet si aspekt i simbolikës së lashtë dhe universalisht njerëzore mbi *samponë*² magjike, por tani anticipimi i fuqishëm poetik me vrull të pandalshëm e shpëton anijen nga fundosja për shkak të prapësisë njerëzore. Një qëndrim moral kundër ecjes qençe, *sy i shkyer në frëngji të nxirë* revolti e mund shëmtinë:

*qeni cofi duke lebur
pas qiellit pas tokës.*

Revolti ruan atë që doemos duhet ruajtur, drejtimet betejat qytetet.

Nëpër gofin moral poeti nisët “drejt diellit” në zenit, kërkon që të hapen dritaret dhe zemrat, ëndrra shekullore e njeriut është e qenmja e bukur e tij. Poeti shkruan kundër vdekjes si dekompozim, shthurje, kundër *tmerrit të betonit dhe makinave të qenve të ngordhur*, poeti ofron ujin rërën barin si çiltërti, e jo kopjen e Evropës sypagjumë, kërkon thjeshtësinë dhe lashtësinë *pa kozmetikë pa patetikë*, dhe jo *Evropën e kashelasheve të myshqeve të podrumeve*. Elegjitë e tij janë më shumë shprehje diskrete e dashurisë së madhe se sa dhimbë, humbje. Edhe ato i përshkon tmerrri, rrëfimi mbi gjallesën në zezonë. Poeti është kundër vetmisë së njeriut si valle e lashtë, e humbur, humbëtirë, se çelësi i saj ndryshket kur fati e braktis e del prej lojës.

Të tmerrshme në fuqinë dhe karakterin e tyre të pakompromis janë vargjet mbi orën që ndal tiktakun, lëvizjen e akrepave, mbi shenjat e lëvizjeve të njeriut të gjallë, mbi epokën që e nxjerr njerinë prej lojës, por, janë njëherit edhe mbi dhimbjen që humb drejtpeshimin e vet, ngrohtësinë, dhe poeti e shpirtëron prishjen me një aktualizim...

Në këtë poezi-varrim nuk vijnë vetëm frikacakët, sepse ata janë të pangushëllueshëm, ndërsa në dashurinë e fisit flaket tej

¹ V. qasjen e librit të Ali Podrimjes me këtë titull në hyrjen tonë.

² V. qasjen e bërë librit të Ali Podrimjes me këtë titull në hyrjen tonë.

sëmundja, vdekja, i jipet fund dezinfektimit të ëndrrave jetësore, të ëndrrave njerëzore. Kjo poezi e tmerrit në këtë inaugurim të mrekullue-shëm të këtij tipi të ri të shkrimit poetik te ne shpie te revolti kundër tmerrit: ajo çliron dhe obligon. Angazhon.

Për poetin jeta është e shenjtë si pafajësia e fëmijës që pagëzohet kësisoji:

*në syrin tënd Flaka Etja Qielli
në syrin tënd
asnjë dredbi asnjë mllef.*

Këtu shihet se si vdekja me fuqinë e poezisë shndërrohet në respekt ndaj jetës në përgjithësi:

*syri yt mbyllet
dhe frëngjia në Kullë.*

një qëndresë dhe qëndrim kundër notimit të notuesve sa për të notuar nëpër vdekje, sepse, më në fund, *çdo fund s'është tragjik*. Kjo është kacafytje e këngës me vdekjen ku triumfon krijimtaria, e cila, këtë herë, nuk ka nevojë të quhet epike as kreshnike, sepse është njëmend burrërore.

1982

Mensur Raifi

PËRMBAJTJA

LUM LUMI	7
BUZË UJIT TË MADH	9
A do të ketë kohë	9
Nokturno.....	10
Këlthitje	11
Myshku, emri	12
Uji i madh.....	13
Vapa	14
Ai det.....	15
Mbreti im i vdekur Dioklecian	16
Monstrumi.....	17
Dumvenio	19
Dikund aty thellë	20
Ujkani.....	22
Kullë e lartë	23
Fati na la?.....	24
ME JETUE	25
Kënga e lirisë	25
Me jetue	26
Kërkon atë që nuk mund ta gjej.....	28
Të duan Lumi	29

Deri në fund.....	30
Ekzistenca	34
Hotel “Moska”, dhoma 512	36
Dhembja ime	37
Në dhomën e vdekjes	38
Nuk të rri bukur asgjësend.....	39
Je e nuk je	40
Besoni nëse keni Zot	42
Shushatje	44
Do të kthej në Tashmejdan	48
Jetë krejtësisht artistike.....	49
Parisi, vendlindja	50
Nën dritare digjej Parisi.....	52
Rrenë klluqe	56
Prapë të lindësh	59
Në fund të botës	63
Nuk kam bërë kurrgjë për Lumin.....	64
Historia e një nëne	70
VDEKJA DHE LUMI	72
Gabove kur the.....	72
Dora ime gjithçka arrin	73
Mbjell qetësi.....	74
Vdektarët.....	75
Kur kapërcen flakën	76
Droj nga sendet	77
Në skaj nate në skaj dite.....	78
Gjysmë në ëndërr.....	79
Nuk më mashtron bukuria jote.....	80
Malum o Lumi.....	81
NË MBRETËRINË E HUMBUR.....	82
Kujtimi për gjahtarin e vjetër	82
Të shkosh në Bejrut.....	83
Unë nuk jam ai	84

Pikëllimë	85
E klith në ëndërr	86
Fillikat vetëm	87
Vdekja më e shpejtë se unë.....	88
E ti i vdekur	89
Në mbretërinë e humbur	90
Fletë e bardhë	91
Kënga e Rexhës	92
Vishkull.....	94
Zbraztësia.....	95
Kujtesa.....	96
Dita që ma kujton vdekjen.....	97
Një jetë.....	99
HYRJE NË TEMPULL.....	100
Përbindëshi	100
Gjarpri, bukuria	101
Besa	102
Dashuria, fjalët.....	103
Ik nga hija jote	104
Dashuria	105
Hyrje në tempull.....	107
Frika	108
Harrimi	109
PASTËRTI NJERËZORE.....	110
Populli.....	110
Shtypi i verdhë.....	113
Pastërti njerëzore.....	114
A kollitet Ivani.....	115
Në Peridellkin	118
Trëndafili i zi.....	119
Zoti Armen	120
Armenia	122
Shthurje	123

Boshësi dhe hiç.....	124
Para të panjohurës.....	125
Ti ende udhëton	126
Drejtëshimi	127
Çështje	128
Trajta, origjina.....	129
KËRKOJ NJERI.....	130
Mora udhë të takoj njeri.....	130
Gjumi i tokës	131
Shpjegimi i dhembjes sime	133
FUND I GËZUAR.....	135
Fati.....	137
A JU KUJTOHET	138
Konstantini	138
Si e kemi zbuluar detin	142
Kruja	144
Skënderbeu.....	145
Kur uji arrinte kulmin e shtëpisë	146
Ndjenja	147
A JU DËGJON HARRIMI	148
Arbëreshi dhe deti.....	148
Fshatrat arbëreshe.....	149
Te De Rada në Maki.....	151
Valle arbëreshe	153
Idilë	154
Zefi ynë.....	155
A ju dëgjon harrimi.....	156

REKUIEM PËR PYLLIN E PRERË	157
Itaka.....	157
Rekuiem për pyllin e prerë.....	158
Fluturim i përgjakur	159
Boçarët.....	160
Shiu i Pargës.....	162
Koha kaloi aq shpejt pranë meje.....	164
Ura e Artës	165
Të guri i Prevezës.....	166
Morea	168
Fusha e Atikës	169
Kthimi në antikë.....	170
Beteja e askujt.....	171
Llapi	172
Në Zatriq.....	174
Elegji muzgu	175
Kërkoje yllin.....	176
Rektimë.....	177
E dashur	178
Pusi.....	179
Mbi qenin	180
Pa titull.....	181
Muri.....	182
Livadhi.....	184
Këngë shendi	185
Happy end.....	187
Burrërore	189
Teksti ynë	190
HIJA IME.....	191
Pastrimi i shtëpisë	191
Mbeturina	192
Uallt Dizni.....	193
Letër mikut.....	194
Narcisi.....	195

Nën hënë.....	196
Qeçe.....	197
Unë jam egërsirë.....	198
Nëse	200
Pasqyra.....	201
Hija ime	202
Fajtor është shqiptari.....	203
ZARI	207
Udhët	209
KUJTIMI PËR NËNËN DHE HËNËN	210
Pishina.....	210
Molla e Nënës.....	212
Kujtimi për Nënëen dhe Hënëen	214
Mosiu i Malit të Shenjtë	216
Këlyshi	218
Duke lexuar pikëllimin e Hana D.....	219
Korona.....	220
Kush do ta vrasë Ujkun	221
Hora e Arbëreshëve.....	222
KËNGA E MËNGJESIT	223
Minjtë.....	223
Imazhe nga qyteti i derdhur.....	225
Odë Anteu.....	227
Jashtë vetes.....	229
Intermexo.....	230
Kënga e mëngjesit.....	231
Baladë për një qen.....	232

DIELLI LIND NË PERËNDIM	233
Molla në degë.....	233
Të duan Lumi	234
Fëmija vdes në bodrum.....	235
Kontejneri	236
Zoti të dhashtë	238
Dhoma 512	239
Njeriu i urtë i Drinisë	240
Letrat.....	241
Dielli lind në perëndim.....	242
A GJUHEN PËLLUMBAT	243
Dallimi	243
Kukullat	244
Tatëpjetës	245
A gjuhen pëllumbat.....	246
Eklipsi.....	248
Më jetohet	249
Kur i munda zotërat	250
Ku vemë	251
NGJITJA KAH MAJA	252
Gjaku i shprishur.....	252
Rektime për njeri.....	254
Fotografia nga faqja e pare	255
Kur do të flasësh o Ali Podrimja	256
Neveria	259
Dalje nga rrethi.....	260
Katrenë.....	261
Ngjitja kah maja.....	262
Thellë në natë	263
Diku në botë.....	264
Zari.....	265
QËNDRIMI JETË-E-VDEKJE-PËRQAFUAR.....	267

ALI PODRIMJA

VEPRA

Vëllimi i katërt

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 17.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Podrimja, Ali

Vepra =Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 4 : Lum Lumi ; Fundi i gëzuar ; Zari. - 280 f.,
portreti i autorit

Qëndrimi jetë-e-vdekje-përqaftuar / Mensur Raifi : f. 267-271

ISBN 978-9951-615-14-3

ISBN 978-9951-615-18-1